



Bashkimi Evropian

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Kosovë

Raporti vjetor

01.01.2012 – 31.12.2012

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	5
2.	Korniza rregulluese	5
2.1.	Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË.....	5
2.2.	Koncepti llogaridhënës i EULEX-it në Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009	6
2.3.	Zbatimi i instrumenteve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.....	6
3.	Paneli dhe Sekretariati	6
3.1.	E përgjithshme	6
3.2.	Sekretariati – Të dhëna biografike	11
4.	Aktivitetet e Panelit	13
4.1.	Fushata informuese 2012.....	13
4.2.	Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it.....	14
4.3.	Faqja e internetit.....	14
4.4.	Numri i lëndëve	14
4.5.	Subjekti i ankesave	16
5.	Jurisprudenca e Panelit.....	17
5.1.	Juridiksioni dhe pranueshmëria	17
a.	Afati kohor.....	19
b.	Statusi i viktimës	20
5.2.	Çështjet procedurale.....	20
a.	Propozimi për zbatimin e masave të përkohshme nga EULEX-i	21
5.3.	Meritat.....	21
a.	Nuk ka shkelje të nenit 2 dhe nenit 8.....	21
6.	Çështjet operative/administrative/të personelit.....	22
6.1.	Fushata informuese.....	22
6.2.	Papranueshmëria e ankesve	23
6.3.	Çështjet e personelit	23
6.4.	Buxheti.....	24
7.	Komente ndërkombëtare rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut	24
7.1.	Përparësitë e Panelit	25
7.2.	Sfidat për Panelin	25
7.3.	Përfundim.....	26
8.	E ardhmja e EULEX-it dhe sfidat rreth të drejtave të njeriut në të ardhmen.....	26
9.	Komentet përmbyllëse.....	28
SHTOJCA 1	Tabela e personelit.....	31
SHTOJCA 2	Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera	32
SHTOJCA 3	Statistikat 2010 - 2012	35
SHTOJCA 4	Vendimet e PShDNj-së 2010-2012.....	36
SHTOJCA 5	Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i Bashkimit Evropian: ...	39
SHTOJCA 6	Tabela e jurisprudencës	47

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Parathënie

Ky është raporti i tretë vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: Paneli). Paneli është themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009, e që është bërë operativ në qershor të vitit 2010. Paneli ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorin e drejtësisë, policisë dhe doganave, si dhe ka zhvilluar edhe më tutje jurisprudencën e vet.

Gjatë vitit 2012 përpos takimit me Grupin Punues të CivCOM në Bruksel, Paneli ka zhvilluar katër seanca. Është vërejtur se ka pasur një rritje të madhe të numrit të lëndëve, ku janë pranuar njëzet e tre ankesa të reja. Gjatë periudhës raportuese Paneli është marrë me shtatëmbëdhjetë ankesa dhe është vërejtur se një përqindje e lartë e ankesave ishin të papranueshme.

Paneli ka vazhduar fushatën informuese duke u përqendruar më së shumti në OJQ-të të cilat merren me të drejtat e njeriut, përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe në organet kishtarë e fetare në Kosovë dhe Serbi. Gjithashtu Paneli ka marr pjesë në intervista në televizion e radio, debate, e po ashtu ka marrë pjesë në seminare të ndryshme rreth të drejtave të njeriut, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta.

Gjithashtu Paneli ka zhvilluar në Serbi vizitën e dytë në kuadër të fushatës informuese, ku ka mbajtur takime në nivelin qendror, dhe takime me OJQ të ndryshme në Beograd dhe Nish lidhur me fushën e të drejtave të njeriut në Serbi.

Përpos përpjekjeve të mëdha për zbatimin e fushatës informuese për të tretin vit me radhë, ende ekziston një mungesë alarmuese e njohjes së Panelit në një zonë të gjerë ku vepron misioni. Paneli mendon se ky boshllëk mund të trajtohet vetëm përmes një fushate të shtuar në TV/radio, e cila shpresohet se do të filloj më 2013 se bashku me një rritje të aktiviteteve të rregullta të fushatës informuese e cila është në vazhdim e sipër.

Siç u përmend më herët, në maj të vitit 2012 Paneli dhe Sekretariati kanë raportuar në Komisionin e Bashkimit Evropian për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave (CIVCOM) rreth aktiviteteve të veta, qysh prej takimit të fundit me Grupin Punues më 10 qershor 2010.

Për më tepër, Paneli ka nxjerrë Buletinin e vet më 30 nëntor. Ky buletin njofton lexuesit rreth aktiviteteve të Panelit dhe do të ndihmojë në rritjen e njohjes publike të mandatit dhe operacionit të tij. Buletini përmban informata rreth çështjeve operacionale, administrative dhe ligjore dhe do të publikohet çdo dy muaj.

Ka pasur disa ndryshime në përbërjen e Panelit gjatë periudhës raportuese, me dorëheqjen e kryesuesit z. Antonio Balsamo-së pas përfundimit të mandatit të tij. Më pastaj znj. Magda Mierzevska ishte zgjedhur kryesuese. Znj. Anna Bednarek si anëtare e Panelit pas përfundimit të mandatit të saj ishte zëvendësuar nga ish

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

anëtarja zëvendësuese znj. Verginia Micheva-Ruseva. Z. Guenael Mettraux ka zëvendësuar z. Balsamo si anëtar i Panelit, ndërsa znj. Katja Dominik është emëruar për të zëvendësuar znj. Micheva-Ruseva, ish anëtare zëvendësuese.

Gjithashtu ka pasur disa ndryshime në përbërjen e personelit të Sekretariatit të Panelit tek zyrtarët ligjor. Znj. Stephanie Selg dhe znj. Leena Leikas kanë dhënë dorëheqje. Ato janë zëvendësuar nga znj. Joanna Marszalik dhe z. Florian Razesberger.

Dëshiroj të shfrytëzoj këtë mundësi të shpreh falënderimin tim për të gjithë anëtarët e Panelit, dhe personelin e Sekretariatit qofshin ata që kanë qenë më herët apo të tanishmit për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm profesional në punën e Panelit gjatë periudhës raportuese. Njësoj, dëshiroj të shpreh falënderimin tim të sinqertë për shefin e Misionit të EULEX-it dhe shefin e Zyrës Ligjore dhe të Drejta të Njeriut të EULEX-it, dhe përgjithësisht për EULEX-in për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre gjatë gjithë vitit.

Magda Mierzevska
Kryesuese
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

1. Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: Paneli) i themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv gjatë gjithë vitit 2012, i cili është viti i dytë i punës së tij. Sidomos Paneli është mekanizëm i parë dhe i vetëm i pavarur që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga një Mision i Politikës së Përbashkët i Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Paneli ka zhvilluar katër (4) seanca dhe ka pranuar njëzet e tre ankesa të reja. Paneli ka shqyrtuar tetë ankesa të papërfunduara që janë bartur nga viti 2011. Paneli ka gjetur se dy prej këtyre ankesave janë të pranueshme, ndërsa katër të papranueshme dhe se i ka komunikuar për vërejtje pesë të tjera tek shefi i Misionit.

Gjithashtu Paneli ka shqyrtuar dhjetë prej njëzet e tre ankesave që i ka pranuar në vitin 2012. Pesë prej këtyre ankesave janë gjetur të papranueshme dhe pesë të tjera janë komunikuar tek shefi i Misionit.

Paneli ka vazhduar me fushatën informuese, duke u përqendruar më së shumti në OJQ-të që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe organet kishtare e fetare në Kosovë dhe Serbi. Gjithashtu Paneli është angazhuar në intervista në radio dhe televizion dhe ka ndjekur konferenca të ndryshme lidhur me të drejtat e njeriut, seminare dhe diskutime në tryeza të rrumbullakëta.

Paneli gjithashtu ka zhvilluar vizitën e dytë në Serbi në kuadër të fushatës informuese, ku ka mbajtur takime me nivelin qendror qeveritar dhe ka takuar OJQ të ndryshme në Beograd dhe Nish, të cilët merren me fushën e të drejtave të njeriut në Serbi.

Me gjithë përpjekjet e mëdha për të zbatuar fushatën informuese, ende ekziston një mungesë alarmuese e njohjes së Panelit në një hapësirë të gjerë ku vepron misioni. Paneli mendon se ky boshllëk mund të trajtohet vetëm përmes një fushate të shtuar në TV/radio, e cila shpresohet se do të filloj më 2013 se bashku me një rritje të aktiviteteve të rregullta të fushatës informuese e cila është në vazhdim e sipër.

2. Korniza rregulluese

2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË.

Veprimi i Përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencës së misionit të EULEX-it në Kosovë. Ai përcakton mandatin e EULEX-it, dhe ndër të tjera, saktëson llogaridhënien e tij lidhur me të drejtat e njeriut në nenin 3 (i):

“siguron se të gjitha aktivitetet e saj respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore”.

2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it në Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Krijimi i një mekanizmi efektiv dhe transparent i të drejtave të njeriut është cilësuar të jetë një nevojë thelbësore për EULEX-in në Kosovë, si Mision për Sundimin e ligjit, të cilit ju janë dhënë disa funksione të kufizuara ekzekutive.

Një mekanizëm i tillë i jashtëm llogaridhënës do të shërbej për të plotësuar llogaridhënien e përgjithshme të EULEX-it në Kosovë, siç ofrohet nga Polica e Sigurimeve të Përgjegjësishë ndaj Palës së Tretë dhe nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it, të cilat janë themeluar që në fillim.

Kështu, Koncepti llogaridhënës përcakton mandatin e Panelit për të shqyrtuar ankesat nga secili person, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë kryerjes së mandat ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

Paneli ka miratuar Rregulloren e vet të Punës me datën 10 qershor 2010, prej kur edhe është autorizuar t'i pranoj ankesat.

2.3. Zbatimi i instrumenteve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut

Sipas dispozitave të Konceptit llogaridhënës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat sipas këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (KDCP, 1966);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (KDEShK, 1966);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG, 1979);
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KKT, 1984);
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat e Fëmijës (KDF, 1989).

Në praktikë, ankesat e parashtruara deri më sot kryesisht janë bazuar në nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj.

3. Paneli dhe Sekretariati

3.1. E përgjithshme

Gjatë periudhës raportuese, ka pasur disa ndryshime në përbërjen e Panelit. Z. Antonio Balsamo, kryesues, ka dhënë dorëheqje pas përfundimit të detyrës së tij, ku ai si kryesues i

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Panelit ishte zëvendësuar nga anëtarja e Panelit, znj. Magda Mierzevska. Znj. Anna Bednarek, anëtare e Panelit gjithashtu ka përfunduar detyrën e saj dhe ishte zëvendësuar nga ish anëtarja zëvendësuese, znj. Verginia Micheva-Ruseva. Z. Guenaël Mettraux ishte caktuar për ta zëvendësuar z. Balsamo-n si anëtar i Panelit dhe znj. Katja Domenik ishte caktuar që të zëvendësoj znj. Micheva-Ruseva si anëtare zëvendësuese.

Gjithashtu ka pasur ndryshime në personelin e zyrtarëve ligjor tek Sekretariati i Panelit, ku znj. Stephanie Selg dhe znj. Leena Leikas kanë dhënë dorëheqje pas përfundimit të detyrës së tyre. Ato janë zëvendësuar nga zyrtarët ligjorë: znj. Joanna Marszałik dhe z. Florian Razesberger.

Anëtarët e Panelit – Të dhëna biografike

Paneli përbëhet prej tre anëtarëve, përfshirë kryesuesen dhe një anëtar zëvendësues të EULEX-it.

Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzevska, shtetase e Polonisë, ka kaluar me sukses Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistrisë të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar si juriste në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të të drejtave të njeriut.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzevska përfshijnë: Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Dhjetë vjet pas: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Dhjetë vjet pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008.

Anëtarët

Znj. Verginia Micheva-Ruseva

Znj. Verginia Micheva-Rusev, shtetase e Bullgarisë, ka diplomuar në Universitetin e Sofjes në Bullgari në nivelin e magjistrisë të drejtësisë në vitin 1995 dhe ka kaluar provimin shtetëror të Bullgarisë për poste gjyqësore në dhjetor të vitit 1995. Gjithashtu ajo ka kryer kurse të

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

ndryshme ligjore, duke përfshirë edhe kurset mbi ligjin e të drejtave të njeriut, për të cilën ka marrë certifikata.

Ajo ka shërbyer si gjykatëse gjatë gjithë karrierës së saj pesëmbëdhjetë vjeçare profesionale. Ajo filloi karrierën e saj gjyqësore si gjykatëse e re, pastaj ajo më vonë shërbeu si gjykatëse e Gjykatës Komunale për tetë vjet dhe pastaj u emërua gjykatëse e Gjykatës së Qarkut nga këshilli i lartë gjyqësor.

Në Gjykatën Komunale dhe në Gjykatën e Qarkut znj. Micheva-Ruseva është marrë me raste civile dhe penale, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut në rastet e diskriminimit të paligjshëm, diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, ngacmimit seksual, qasjes në informata personale, zbulimit të informatave dhe mjeteve juridike, konfiskimit të pasurisë, etj.

Përveç studimeve në magistraturë rreth të drejtave të njeriut, ajo ka përfunduar shumë kurse rreth KEDNj-së dhe protokolleve të saj, dhe gjithashtu si gjykatëse e re ajo ka studiuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në shtator të vitit 2008 ajo ka marrë pushim të jashtëzakonshme nga gjykata e saj shtetërore pasi u emërua që të shërbej si gjykatëse civile në nivelin e Gjykatës së Qarkut në Misionin e EULEX-it në Kosovë.

Znj. Micheva-Ruseva ishte emëruar si anëtare zëvendësuese e Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga shefi i misionit të EULEX-it më 6 korrik 2011.

Dr. Guénaël Mettraux

Dr. Guénaël Mettraux, shtetas i Zvicrës ka diplomuar për juridik (en droit) në Universitetin e Lozanës (Zvicër), ka magjistruar për juridik (LLM) në të drejtën ndërkombëtare nga Kolegji Universitar i Londrës dhe ka doktoruar në Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike (Mbretëria e Bashkuar).

Dr. Mettraux punon si avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdemit (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut (Zvicër).

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial (Përshkrimi i Gjykatës së Nyrembergut)* (Oxford University Press, 2008) dhe *The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese)* (Oxford University Press, 2009), e cila kishte marrë çmimin Lieber nga *American Society of International Law* (Shoqata Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare). Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të *Revistës së Drejtësisë Penale Ndërkombëtare* dhe i Këshillit Redaktues të *Revistës së Drejtës Penale Ndërkombëtare*.

Anëtarja zëvendësuese

Znj. Katja Dominik

Znj. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar drejtësinë dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996. Znj. Domenik kishte një interes të vazhdueshëm në të drejtat e njeriut atëherë kur ajo filloj studimet për juridik në fillim të viteve 90-ta. Si studente e juridikut ajo ishte anëtare e shoqatës “Geschichtswerkstatt” (Punëtori rreth historisë) në Goettingen, që ka hulumtuar përndjekjen e popullatës hebreje nga Goettingen-i mes viteve 1933 dhe 1945.

Pas diplomimit në Universitetin e Goettingen-it në vitin 1996, ajo filloj punën si asistente për hulumtim në Institutin për Ligjin e përbashkët Shtetëror dhe Shkenca Politike në Gjermani. Në këtë detyrë, ajo i ka ndihmuar drejtorit të Institutit me ligjërata si dhe me publikime të shumta shkencore në të Drejtën Publike, të Drejtën Kushtetuese dhe të Drejtën Ndërkombëtare. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë aktive me avokatë dhe studentë të juridikut, të cilët janë marrë me çështjet e azilit dhe çështje të tjera të të drejtave të njeriut nga viti 1996 deri në vitin 1999.

Znj. Domenik ju është dhënë bursë pasdiplomike, ku ka përfunduar studimet rreth aspekteve ligjore të shkatërrimit të shtetit të Ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci në vitin 1998/99. Disertacioni i saj ishte botuar në vitin 2001. Ajo gjithashtu ka punuar rregullisht gjatë kësaj periudhe për një kohë të shkurtër si vëzhguese e votimeve dhe mbikëqyrëse në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Bosnje dhe Hercegovinë.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë, e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo u punësua nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku ajo punoj në Divizionin për politikë zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, znj. Domenik është emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Duseldorf, ku është specializuar në lloje të ndryshme të ligjit penal. Më pas, ajo u bë zëvendëse kryetare në dhomën penale për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike në Gjykatën e Qarkut.

Znj. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX në Kosovë në tetor të vitit 2011, ku më pas ajo u caktua në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të një profili të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Shefi i misionit të EULEX-it ka emëruar znj. Domenik anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2012.

Ish anëtarët e Panelit, të cilët kanë shërbyer në vitin 2012

Z. Antonio Balsamo, shtetas i Italisë, ka diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Jurisprudencës, Universiteti i Palermos në Itali në dhjetor 1986. Ai specializoi në të Drejtën e Pushtetit Rajonal dhe Lokal në Universitetin e Palermos në vitin 1991.

Ai punoi si gjykatës në Gjykatën e Palermos nga viti 1995-2007 ku u mor me shqyrtimin e shumë lëndëve të rëndësishme, përfshirë këtu edhe gjykimin e Giulio Andreottit, lidhur me marrëdhëniet e ndërlikuara që ekzistonin mes krimit të organizuar dhe institucioneve publike. Z. Balsamo ishte kryesues i Gjykatës, e cila urdhëroi konfiskimin e pasurive të mafisë së Sicilisë me një vlerë prej qindra miliona euro në vitin 2002.

Z. Balsamo ishte i punësuar në Gjykatën Supreme të Kasacionit në Itali prej vitit 2007 deri në shtator 2011. Ai ishte përgjegjës për trajnimin profesional të gjykatësve dhe prokurorëve të Gjykatës Supreme të Italisë.

Në shtator 2011 z. Balsamo ishte emëruar kryetar i Seksionit të Parë të Gjykatës së Assize të Caltanissetta-së, kompetente për gjykimet në lidhje me krimet më të rënda të kryera në qarkun qendror të Sicilisë dhe vrasjet e gjykatësve dhe prokurorëve që punonin në Palermo. Gjithashtu ai ka kryesuar Gjykatën, përgjegjëse për konfiskimin e pasurisë që i përkisnin grupeve mafioze.

Ai është anëtar i Komitetit Rajonal Shkencor i Institutit Ndërkombëtar të Studimeve të Larta në Shkencën Penale, anëtar i Këshillit Udhëheqës të Shoqatës së gjykatësve të Italisë, drejtor i revistës *“La Magistratura”* si dhe anëtar i Komisionit Shkencor i revistës *“Archivio Penale”*. Ai gjithashtu është profesor i së drejtës penale në shkollën e specializimit pasuniversitar për profesionin juridik.

Z. Balsamo është ekspert gjyqësor i së drejtës evropiane, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rreth çështjeve kriminale. Ai ishte edhe anëtar i Këshillit Shkencor në Këshillin e lartë italian për Gjyqësi dhe i Komisionit për Reformimin e Ligjit Penal të Italisë. Ai gjithashtu mori pjesë si konsulent ekspert në projektet e Bashkimit Evropian që kishin të bënte me reformimin e ligjit penal të Bullgarisë, si dhe themelimin e Zyrës së Prokurorit Publik për t'u përballur me krim të organizuar dhe korrupsion në IRJM dhe trafikim me qenie njerëzore në Turqi.

Ai ka redaktuar librin *“Giurisprudenza europea e processo penale italiano”* mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimin e saj në ligjin për procedurën penale të Italisë. Ai gjithashtu ka botuar një libër mbi dëshmitë nga thashethemet dhe mbi masat anti-mafia, si dhe disa artikuj në revistat e specializuara shkencore dhe kaptina librash mbi tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar.

Znj. Anna Bednarek, shtetase e Polonisë, ka diplomuar në Universitetin e Gdanskit në Poloni në nivelin e magjistratit të drejtësisë (LLM) në vitin 1994, ndërsa ka kaluar provimin shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1997. Ajo përfundoi studimet e saj pasuniversitare si gjyqtare civile në Akademinë e Shkencave të Polonisë në Varshavë, si dhe studimet e saj

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

pasdiplomike në Institutin e Shkencës së vendeve në zhvillim në Universitetin e Varshavës me disertacionin rreth Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve në 2008/2009.

Znj. Bednarek ka punuar si eksperte e lartë në zyrën e agjentit të Qeverisë së Polonisë në Komisionin Evropian dhe në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, në Divizionin e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave Kombëtare, Departamentin Ligjor dhe të Traktatit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë në Varshavë, dhjetor 2007. Gjithashtu ajo ishte anëtare e Delegacionit të qeverisë së Polonisë për seancën e 54-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në vitin 1998.

Znj. Bednarek ishte emërua si gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Varshavë në qershor të vitit 1998, ku shërbeu deri në vitin 2001, dhe pastaj ajo ishte punësuar si konsull në Ambasadën e Polonisë në Romë, Itali nga viti 2001 deri në vitin 2007.

Ajo ka punuar si gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Varshavë, (Sąd Rejonowy dla Warszawy-Śródmieścia w Warszawie) nga prilli i vitit 2007 deri në janar të vitit 2009. Më pas ajo ishte emëruar gjykatëse e EULEX-it në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ku ajo ka punuar prej janarit të vitit 2009.

Në vitin 2008 ajo ka marrë pjesë si trajnuese lidhur me “Trafikimin e qenieve njerëzore-Trajnim për gjykatës”. Projekti kishte për qëllim të luftonte trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë. Ky projekt ishte organizuar nga Fondacioni La Strada nga Varshava, Poloni, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme të Polonisë dhe Ambasadën Britanike në Varshavë.

Znj. Bednarek gjithashtu ka punuar për Amnesty International si menaxhere projekti e një projekti në Poloni për publikimin e një doracakut shkollor për të Drejtat e Njeriut dhe si bashkërenduese e grupit lobues.

Znj. Bednarek ishte emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) të EULEX-it nga shefi i Misionit të EULEX-it më 25 maj 2011, e pastaj ajo ishte emëruar si anëtare e Panelit nga shefi i Misionit të EULEX-it më 12 korrik 2011.

3.2. Sekretariati – Të dhëna biografike

Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari të lartë ligjor, dy zyrtarë ligjor, një asistente administrative/gjuhësore dhe dy interpret/përkthyes.

Z. John J. Ryan, shtetas i Irlandës, ka diplomuar për Drejtësi me titullin Bachelor, (Hons) në Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë, dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat me Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors, në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timorin lindor, Nepal, Kosovë dhe në Komisionin Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme ai kishte punuar në UNMIK, ndër të tjera, si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, Shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut. Ai është emëruar zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit të Paneli në prill 2010. Artikulli i tij rreth Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë është botuar në Revistën e Forcave të Mbrojtjes së Irlandës në vitin 2010.

Znj. Joanna Marszalik, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Drejtësi në nivelin master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar si juriste në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit për Këshillin e institutit të Evropës në projektin ndërtues institucional “Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë” dhe udhëheqëse ekipi e këshillit të Evropës dhe projektit të Bashkimit Evropian “Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Juridik në Ukrainë”, e cila ka mbështetur reformat e sistemit juridik të Ukrainës. Ajo ju bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku punoj si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit në prill të vitit 2012.

Z. Florian Razesberger, shtetas i Austrisë, ka studiuar për juridik në Universitetin e Vjenës, Kopenhagës dhe Innsbruck-ut (shkalla e masterit në vitin 2001, shkalla e doktoratës në vitin 2005). Ai fillimisht ka punuar si nëpunës ligjor në Gjykatën Rajonale të Innsbruck-ut dhe u emërua si asistent zyrtar ligjor brenda Presidencës dhe Dhomës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë. Më pastaj, ai u emërua këshilltar ligjor në OJQ-në britanike për ndihmë ligjore, Africa Middle East Refugee Assistance në Kairo, Egjipt. Më pas, ai u emërua zyrtar ligjor në sektorin për reformë gjyqësore dhe të drejta të njeriut në misionin e OSBE-së në Shkup dhe Sarajevë (ku ka punuar për 5 vite). Më pas, ai u emërua zyrtar për të drejtat e njeriut dhe udhëheqës ekipi për misionin e asistencës së Kombeve të Bashkuara në Afganistan. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut në EULEX para se t’i bashkëngjitej Sekretariatit të PShDNj-së.

Znj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në Universitetin AAB, Prishtinë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri në mars të vitit 2009. Ajo është asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku i vitit 2010.

Znj. Katica Kovaçević, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo filloj punën si interprete/përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

Z. Kushtrim Xhaferi, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si interpret/përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të

vitit 2009, dhe më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si interpret/përkthyes në Sekretariat që nga muaji shtator i vitit 2010.

Ish personeli i Sekretariatit, të cilët kanë shërbyer gjatë vitit 2012

Znj. Leena Leikas, shtetase e Finlandës, ka diplomuar në shkallën master në Drejtësi në Universitetin Turku, në Finlandë dhe pastaj u kualifikuar si gjykatëse. Pas disa viteve në Departamentin e Hartimit të Ligjeve, në Ministrinë e Drejtësisë, ajo ishte punësuar nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa në Departamentin Ligjor, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku specializoj në çështjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Nga nëntori i vitit 2007 e deri në prill 2010 ajo ka punuar si avokate për përpunimin e lëndëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ishte caktuar zyrtare ligjore në Sekretariatin e Panelit në maj të vitit 2010.

Znj. Stephanie Selg, shtetase e Zvicrës, ka diplomuar në shkallën master në Drejtësi në Universitetin e Bazelit dhe Gjenevës, në Zvicër. Gjatë studimeve, ajo ka specializuar në ligjin humanitar ndërkombëtar dhe ligjin e të drejtave të njeriut, duke marrë një certifikatë të Ligjit Ndërkombëtar nga Universiteti i Gjenevës. Pas praktikës ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative të qarkut të Bazelit dhe Gjykatës së Apelit të Bazelit në Zvicër, ajo ishte punësuar nga qeveria e Zvicrës si këshilltare ligjore dhe këshilltare e lartë ligjore në Praninë e Përkohshme Ndërkombëtare në Hebron (TIPH) në Bregun Perëndimor, Izrael. Ajo ka qenë anëtare e Grupit të Ekspertëve Kombëtar të Zvicrës për ndërtimin e paqes civile që nga viti 2009. Nga tetori i vitit 2010 deri në prill të vitit 2011 ajo ka punuar si këshilltare ligjore dhe zyrtare për kërkime në fushën e së drejtës ndërkombëtare pranë Forumit zviceran për të drejtat e njeriut në Bern të Zvicrës. Ajo ishte caktuar zyrtare ligjore pranë Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në muajin qershor të vitit 2011.

[Shih shtojcën nr. 1. Tabela e stafit](#)

4. Aktivitetet e Panelit

4.1. Fushata informuese 2012

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar me zbatimin e fushatës informuese gjatë vitit 2012. Synimi kryesor i fushatës u përqendrua në OJQ, përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe në organe të tjera kishtarë e fetare. Paneli gjithashtu është angazhuar në intervista në radio dhe televizion, ndërsa Sekretariati ka përcjellë konferenca, seminare, dhe debate të ndryshme që kishin të bënin me të drejtat e njeriut. Posaçërisht, Paneli po ashtu ka realizuar vizitën e tij të dytë në kuadër të fushatës informuese në Serbi.

Karakteri i takimeve gjatë fushatës informuese përbëhet prej një prezantimi të shkurtë rreth mandatit, procedurave, funksioneve dhe punës së Panelit, si dhe një njoftim i shkurtë rreth ligjit në fuqi sipas të cilit funksionon Paneli. Ka pasur gjithashtu edhe vend për pyetje e përgjigje, por edhe për diskutime e debate atëherë kur ka qenë e nevojshme. Gjithashtu

është prezantuar dhe shpërndarë materiali njoftues i Panelit, si broshurat dhe posterët, të cilët janë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Gjatë kësaj vizite në kuadër të fushatës informuese në Serbi në muajin nëntor, Paneli është takuar në Beograd me përfaqësuesit e zyrës për Kosovë dhe Metohi, qeverisë së Republikës së Serbisë, Ministrisë së Drejtësisë, qeverisë së Republikës së Serbisë si dhe me zyrtarë të Këshillit danez për refugjatë dhe me OJQ përkatëse. Gjithashtu Paneli ka pasur takim me kryetarin e shoqatës së veteranëve serb, si dhe me Komitetin për të drejtat e njeriut në Serbi (CHRIS) në Nish, Serbi.

Përpos kësaj, Paneli dhe Sekretariati janë takuar dhe kanë njoftuar studentët, të cilët janë në studime të magjistraturës dhe doktoratës gjerësisht rreth disiplinave të të drejtave të njeriut, çështjeve ndërkombëtare, disiplinave për demokratizim sipas kërkesës.

[Shih Shtojcën nr. 2 Fushata informuese dhe aktivitetet e tjera](#)

4.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it

Sekretariati ka vazhduar pjesëmarrjen në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për personelin e ri të EULEX-it. Këtu përfshihet një prezantim me programin power point rreth Panelit, gjithashtu me kohë të caktuar për pyetje e përgjigje. Kjo ka një karakter shumë të vlefshme për të njoftuar personelin e ardhshëm rreth mandatit të Panelit dhe për ta bërë edhe më të njohur Panelin tek personeli i EULEX-it në tërë misionin ku vepron. Kjo cilësohet të jetë veçanërisht e rëndësishme lidhur me atë se ajo i ofron Panelit mundësi për të njoftuar personelin e Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it rreth implikimeve në llogaridhënie tek shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ekzekutive. Sidoqoftë, Sekretariati nuk ka qenë në gjendje që të merr pjesë në këtë program trajnues që prej se EULEX-i ka bërë ndryshime në këtë format kah mesi i vitit 2012, pas rikonfigurimit të misionit. Është e kuptueshme se në të ardhmen kjo do të ofrohet nga EULEX-i, kështu që Paneli/Sekretariati mund që të marrin pjesë prapë në programin e trajnimit hyrës.

4.3. Faqja e internetit

Sekretariati është përgjegjës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të Panelit: www.hrrp.eu. Kjo faqe përmban informata të dobishme rreth mandatit, funksioneve, veprimtarive dhe punës së Panelit, si dhe komunikatave për shtyp, statusin e tanishëm të rasteve në pritje dhe rasteve të përfunduara, përfshirë këtu të gjitha vendimet e lëshuara nga Paneli. Aty gjithashtu ka informata rreth ligjit për të drejtave të njeriut në fuqi, si dhe rreth formularëve dhe udhëzimeve për paraqitjen e ankesave në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe. Sekretariati gjatë gjithë kohës përpiqet që edhe më tutje të zhvilloj dhe përmirësoj faqen e internetit.

4.4. Numri i lëndëve

Paneli ka bartur tetë lëndë të papërfunduara nga viti 2011. Ka marrë vendime në gjashtë prej këtyre lëndëve dhe ka gjetur dy ankesa të pranueshme, e që katër kanë qenë të papranueshme, ndërsa i ka komunikuar dy lëndë tek shefi i Misionit. Paneli ka marrë njëzet e tri ankesa të reja gjatë gjithë periudhës raportuese dhe ka shqyrtuar dhjetë prej tyre. Pesë prej këtyre ankesave janë gjetur të papranueshme dhe pesë të tjera i janë komunikuar, sipas

Rregullës 30 të Rregullores së punës së Panelit, shefit të Misionit, të cilit i është kërkuar që të dorëzoj vërejtjet e tij lidhur me faktet dhe çështjet ligjore që përfshihen në këto lëndë.

[Shih Shtojcën nr. 3 Statistikat](#)

Ankesat të cilat përsëriten dhe shtrirja e mjeteve juridike

Një tendencë e re që vërehet në natyrën e ankesave të parashtruara është se në lëndët e pranuar nga Paneli gjatë periudhës raportuese përpos KEDNj-së përmenden edhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Ky model përfshinë shfrytëzimin e një kombinimi të neneve nga instrumente të ndryshme, përpos KEDNj-së dhe/apo protokolleve të saj:

KEDNj dhe/apo protokollet e saj

Shumica e ankuesve pohojnë shkeljet e KEDNj-së dhe/apo protokolleve të saj. Dispozitat e KEDNj-së, në të cilat janë mbështetur ankuesit, janë:

- Neni 2 mbi të drejtën për jetë;
- Neni 3 mbi ndalimin e torturës;
- Neni 5 mbi të drejtën për liri dhe siguri;
- Neni 6 mbi të drejtën për gjykim të rregullt brenda afatit të arsyeshëm;
- Neni 8 mbi të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës;
- Neni 9 mbi të drejtën për liri të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;
- Neni 10 mbi të drejtën për liri të shprehjes;
- Neni 11 mbi të drejtën për liri të tubimit dhe organizimit;
- Neni 13 mbi të drejtën për zgjidhje juridike efektive;
- Neni 1 i protokollit nr. 1 i KEDNj-së mbi të drejtën për gëzim paqësor të pronës.

Konventa e të drejtës së fëmijës

Nenet 6, 24, 28, 29, 31 dhe 37 të Konventës të së drejtës së fëmijës për të parën herë janë përmendur në një ankesë.

Konventa ndërkombëtare e të drejtave civile dhe politike

Neni 9, paragrafi 2 dhe 4 i Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike në lidhje me arrestim dhe paraburgim janë përmendur gjithashtu për herë të parë.

Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut

Neni 10 dhe 11 në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik, si dhe të drejtën për t'u konsiderohet i pafajshëm, përkatësisht i Deklaratës së Përgjithshme mbi të drejtat e njeriut janë përmendur për të parën herë.

Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese

Neni 6, paragrafi 1 dhe 2 i Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore a poshtëruese në lidhje me detyrimet e një shteti sa i përket paraburgimit dhe hetimeve paraprake gjithashtu janë përmendur.

4.5. Subjekti i ankesave

Llojet më të shpeshta të shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut të parashtruara në Panel janë si në vijim:

- Akuzat për shkelje të së drejtës për jetë (Neni 2 i KEDNj-së): Lëndët *W. kundër EULEX-it*, nr. 2011-07 në lidhje me të drejtën për ndalimin e torturës, Neni 3 dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, përkatësisht neni 8; *F. kundër EULEX-it*, nr. 2011-27 në lidhje me të drejtën për ndalimin e torturës, Neni 3, e drejta për liri dhe siguri, Neni 5 dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, përkatësisht Neni 8; *Y. kundër EULEX-it*, nr. 2011-28 në lidhje me të drejtën për ndalimin e torturës, Neni 3, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, Neni 8, e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, Neni 9, e drejta e lirisë së shprehjes, Neni 10 dhe e drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit, përkatësisht Neni 11; *A. kundër EULEX-it*, nr. 2012-09, siç u përmend më lart; *B. kundër EULEX-it*, nr. 2012-10, siç u përmend më lart; *C. kundër EULEX-it*, nr. 2012-11, siç u përmend më lart; *D. kundër EULEX-it*, nr. 2012-12, siç u përmend më lart.
- Akuzat për shkelje të së drejtës për liri dhe siguri, Neni 5, paragrafi 1c, 2, 3 dhe 4 i KEDNj-së, lënda e *Z. kundër EULEX-it*, nr. 2012-6 në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, Neni 6, paragrafi 1, 2, dhe 3a, si dhe Neni 9, paragrafi 2 deri 4 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike në lidhje me Nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNj-së): Lënda *Ventor Maznikolli kundër EULEX-it*, nr. 2011-21; *Qamil Hamiti kundër EULEX-it*; *Fatmir Pajtazi kundër EULEX-it*, 2012-05;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNj-së) në lidhje me shkeljen e së drejtës për gëzim paqësor të pronës së vet, Neni 1 i Protokolit nr. 1 i KEDNj-së: Lëndët *Sefer Sharku kundër EULEX-it*, 2011-19; *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2011-25; *Rexhep dhe Avdush Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03; *Izet Maxhera kundër EULEX-it*, 2012-04.
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, (Neni 6 i KEDNj-së) në lidhje me shkeljen e së drejtës për mjete efektive, neni 13 i KEDNj-së, Lënda *X. kundër EULEX-it*, 2011-20.

- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 i KEDNj-së) në lidhje me shkeljen e gëzimit paqësor të pronës së vet, Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNj-së së bashku me të drejtën për t'u mbrojtur me ligji, Neni 7 i Deklaratës së Përgjithshme të të drejtave të njeriut, Lënda e *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2012-01.

5. Jurisprudenca e Panelit

Paneli ka zhvilluar edhe më tej jurisprudencën e vet gjatë shqyrtimit të ankesave të shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut. Gjatë shqyrtimit të lëndëve, Paneli më së shumti ishte përqendruar në çështjet e juridiksionit dhe pranueshmërisë. Për më tej, Paneli ka shqyrtuar shumë çështje procedurale dhe gjithashtu ka diskutuar ndonjëherë rreth meritave të ankesave, sidoqoftë duke mos gjetur shkelje të të drejtave të njeriut gjatë vitit 2012.

Është krijuar një tabelë e hollësishme e jurisprudencës nga ana e Sekretariatit në pjesën e dytë të vitit 2012, ku përfshihen hollësisht të gjitha vendimet që janë lëshuar deri më tani nga Paneli (shih shtojcën 6). Kjo tabelë është përditësuar rregullisht, ndërsa ajo gjendet në faqen e internetit të Panelit.

5.1. Juridiksioni dhe pranueshmëria

Pjesa më e madhe e jurisprudencës së Panelit i referohet çështjeve të juridiksionit dhe pranueshmërisë. Paneli gjithashtu ishte rregullisht i vendosur në lidhje me kufijtë e juridiksionit të vet përpos çështjeve të përgjithshme si është fushëveprimi të autoritetit shqyrtues të Panelit dhe konceptit llogaridhënës:

a. Procedurat pranë gjykatave të Kosovës

Në disa raste, ankuesit kanë paraqitur argumente se të drejtat e tyre për gjykim të drejtë ishin shkelur. Procedura të tilla kanë të bëjnë qoftë me gjykimet pranë gjykatave të Kosovës pa përfshirjen e gjykatësit të EULEX-it, (krahasoni *Hamiti kundër EULEX-it*, 2012-01, 5 qershor 2012, në paragrafin 17). Gjithashtu krahasoni me lëndët që ju kishin caktuar gjykatësve të EULEX-it nga kryetari i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it sipas modaliteteve të përcaktuara nga Ligji mbi kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe nga EULEX-i në Kosovë.

Në mënyrë të qartë, lëndët në të cilat nuk ka pasur ndonjë gjykatës të EULEX-it në trupin gjykues, kanë dalë jashtë kompetencave të Panelit. Paneli përsërit qasjen e tij të mëhershme dhe konstaton se: "sipas Rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave në Kosovë".

Paneli nuk ka kompetenca as në fushën administrative e as në fushën gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Këto elemente mbeten kompetencë vetëm e gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka konstatuar se "fakti se gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e

trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës”.

Një qasje e tillë ishte ndjekur në lëndën *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012, në paragrafët 9-10; në lëndën *Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03, 4 tetor 2012, në paragrafin 12; në lëndën *Zeka kundër EULEX-it*, 2012-02, 4 tetor 2012 në paragrafin 21; në lëndën *Rexhepi kundër EULEX-it*, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafin 36, dhe në lëndën *Maznikolli kundër EULEX-it*, 2011-21, 20 mars 2012, në paragrafin 15.

b. Veprimet e EULEX-it

Në vitin 2012, Paneli ka përsëritur qëndrimin e vendosur në lidhje me kompetencën e tij për t'i shqyrtuar veprimet apo mos veprimet nga ana e prokurorëve të EULEX-it. Në lëndën *Y kundër EULEX-it*, (2011-28, 15 nëntor 2012) një ish pjesëtar i EULEX-it ka pretenduar se familja e tij ishte vënë në rrezik nga veprimet e një prokurori të EULEX-it, i cili sipas parashtruesit të ankesës, nuk ishte marrë siç duhet me shqetësimet e tij të sigurisë si dëshmitar i mundshëm në një lëndë penale.

Paneli ka konstatuar se “sipas Rregullës 25, paragrafi 1, i Rregullores së Punës, Paneli mund t'i shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve apo të policisë të EULEX-it në Kosovë janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe prandaj hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (p.sh. shih gjithashtu *Lafit Fanaj kundër EULEX-it*, nr. 2010-06, vendimi i datës 14 shtator 2011).” Paneli ka pasur qasje të njëjtë në lëndën *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012, në paragrafin 21.

Në anën tjetër, në një lëndë lidhur me një kontest pronësor, ku ankuesi ka kërkuar nga Paneli që të konstatoj shkeljen, pasi EULEX-i nuk kishte ndërmarrë asnjë masë të përkohshme për të siguruar ushtrimin paqësor të të drejtës së tij në pronë, Paneli ka deklaruar se “mandati i EULEX-it nuk e [ka] autorizuar atë që të ndërmerr masa të tilla, të cilat [ishin] kompetenca vetëm të gjykatave të Kosovës. Prandaj çështja e ngritur nga ankuesi nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë (*Sharku kundër EULEX-it*, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafin 19-20).”

c. Mandati i EULEX-it

Kujdesi, mjekësor, ndotja, çështjet e banimit, mbrojtja e mjedisit

Në lëndën *X dhe 115 ankues të tjerë*, 2011-20, 5 tetor 2012, Paneli është marrë me shëndetin dhe kushtet e jetesës së personave të zhvendosur brenda vendit në Kosovë. Gjatë konfliktit të vitit 1999, shumë familje romë nga Mahalla Rome (gjithashtu e njohur si Fabrika apo Mahalla e Mitrovicës) dhe pjesë të tjera të Kosovës kanë ikur drejt pjesës veriore të Kosovës si rezultat i dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre. Si pasojë, rreth 600 romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës të zhvendosur brenda vendit ishin strehuar në kapet e Personave të Zhvendosur Brenda Vendit (PZhBV). Përderisa shumica e të zhvendosurve të PZhBV-së tashmë janë zhvendosur, ende disa jetojnë në zonat e ndotura nga plumbi.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Kushtet e jetës në kapet e PZhBV-së ishin dhe vazhdojnë të jenë nën nivelin e duhur. Përveç kësaj, qysh në vitin 2000 është konstatuar nga UNMIK-u, KFOR-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) se si rezultat i aktiviteteve të mëhershme xehetare, kjo zonë ishte ndotur shumë, në veçanti përmes ndotjes nga plumbi. Sipas raporteve mjekësore, shumë prej atyre që jetojnë në këto kampe kanë përqendrim të lartë të plumbin në gjak, që e tejkalon nivelin e lejueshëm.

Ankuesit ka pohuar se EULEX-i si “autoritet qeverisës dhe administrator përgjegjës i kampeve të PZhBV-së që nga vitit 2008”, ka qenë i njohur rreth rrezikut të kushteve të jetës, mirëpo nuk ka ndërmarrë asgjë për të rizhvendosur romët nga ai kamp apo për t’i ofruar atyre kujdes shëndetësor.

Në lidhje me këtë, Paneli ka konstatuar se EULEX-i asnjëherë nuk ka qenë në krye të kampeve të PZhBV-së në Kosovë. Në të vërtetë, UNMIK-u ia kishte bartur përgjegjësinë për kampet e tjera, në përputhje me autoritetin e tij, autoriteteve të Kosovës në vitin 2008.

Paneli përsërit çështjen se “EULEX-i në thelb është mision për sundimin e ligjit”. Mandati i përgjithshëm ekzekutiv i EULEX-it nuk përfshinë aktivitetet e një karakteri administrativ për sa i përket çështjeve të banimit, sigurimit të kujdesit shëndetësor, luftimit të ndotjes, mbrojtjes së mjedisit apo çështjeve të politikave sociale. Si pasojë, udhëheqja apo përgjegjësia për administrimin e kampeve të PZhBV-së nuk ishte dhe kurrë nuk ka qenë në kompetencë apo përgjegjësi të tij.

Prandaj, çështjet e ngritura nga ankuesit në lidhje me kushtet e tanishme të përgjithshme të jetës që mbizotërojnë në ato kampe, ndotjen e mjedisit, dëmtimin e dyshuar të shëndetit të ankuesve, kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor, si dhe mos zhvendosja e banorëve të kampit, nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë¹.

Megjithatë, pa i paragjykuar meritat e ankesës, Paneli shpalli këtë ankesë të pranueshme sa i përket çështjes së qasjes në drejtësi sipas Nenit 6 të KEDNj-së, dhe se do të merr vendim rreth meritave në vitin 2013¹.

a. Afati kohor

Paneli ka caktuar datën 10 qershor 2010 si datë në të cilën është autorizuar t’i pranoj ankesat, pasi rregullorja e punës së tij është miratuar në këtë datë. Paneli ka vërejtur më herët se ankesat nganjëherë nuk ishin parashtruar brenda afatit kohor të caktuar me Rregullën 25 (3) të RrP-së, e cila parashikon se:

“Ankesat duhet t’i parashtrohen Panelit brenda tre muajve nga data kur Paneli mund t’i pranoj ankesat, apo gjashtë muaj nga data e shkëljes së supozuar, cilado që është më e favorshme për parashtruesin e ankesës” (pasi ka ndryshuar).

¹ Shumë çështje që dalin në rrethana të ngjashme tashmë janë të shqyrtuara nga Paneli Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut; prandaj krahasoni *N.M. dhe të tjerët*, nr. i lëndës 26/08, në www.unmikonline.org/hrap/Eng/.

Në lëndën *Y. kundër EULEX-it*, 2011-28, (15 nëntor 2012 në paragrafin 25-33), Paneli ka përmendur qasjen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj-së), duke deklaruar se: “Sa i përket datës së afatit të fundit (*ad quem*), GjEDNj-ja shpesh ka konstatuar se afati gjashtë mujor për të parashtruar një ankesë tek ajo Gjykatë fillon të llogaritet nga data pas së cilës vendimi përfundimtar rreth asaj lënde është bërë publik, apo në datën në të cilën aplikanti apo përfaqësuesi i tij ishte njoftuar rreth saj. Për më tepër, në situatat ku nuk ka pasur mjete juridike, ai afat kohor gjithashtu ishte shtyrë për t’u llogaritet nga data në të cilën kishte ndodhur ai veprim rreth të cilit kishte pasur ankesë, apo nga data në të cilën aplikanti ishte prekur drejtpërdrejtë nga apo ishte njoftuar për një vepër të tillë, apo ishte njoftuar për efektet e tij negative. Sa i përket kohëzgjatjes së periudhës gjashtë mujore, ka qenë praktikë e vazhdueshme për GjEDNj-në të konstatoj se ajo skadon gjashtë muaj kalendarikë më vonë, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e vërtetë të atyre muajve kalendarik. (shih Dennis dhe Të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim), nr. 76573/01, 2 korrik 2002 dhe Otto kundër Gjermanisë (vendim), nr. 21425/06, 10 nëntor 2009).”

Paneli ka konsideruar si të përshtatshme që për qëllimet e tij ta miratoj këtë qasje, e cila është krijuar nga GjEDNj-ja sa i përket pikës fillestare, llogaritjes dhe skadimit të afatit kohor prej gjashtë muaj për parashtrimin e ankesave. Ai afat kohor gjithashtu ishte trajtuar nga Paneli gjatë periudhës raportuese në lëndën *Rexhepi kundër EULEX-it*, 2011-23, 20 mars 2012 në paragrafët 39-42.

b. Statusi i viktimës

Paneli ka trajtuar çështjen e statusit të viktimës karshi faktit se procedurat penale kundër ankuesit ishin ndërprerë; autoritetet kanë gjetur se kjo nuk përbën rast kundër ankuesit në bazë të dëshmisë në dispozicion, *Rexhepi kundër EULEX-it* 2011-23, 20 mars 2012 në paragrafët 43-47. Paneli ka deklaruar se “në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, personi nuk mund të pretendoj se është viktimë e ndonjë shkeljeje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas Nenit 6 të KEDNj-së, e cila supozohet se ka ndodhur gjatë procedurave në të cilat personi përfundimisht ishte shfajësuar apo ishte ndërprerë (shih, KEDNj-një, Osmanov dhe Husseinov kundër Bullgarisë (vendim), nos. 54178/00 dhe 59901/00, 4 shtator 2003; Witkowski kundër Polonisë (vendim), nr. 53804/00, 3 shkurt 2003; Oleksy kundër Polonisë (vendim); nr. 64284/01, 28 nëntor 2006).

Si rrjedhojë “çfarëdo mangësie procedurale, e cila mund të ketë ndodhur gjatë hetimit duhet të konsiderohet se është korriguar përmes ndërprerjes së procedurave dhe përmes shfajësimit të emrit të parashtruesit të ankesës”.

5.2. Çështjet procedurale

Siç përshkruhet në Tabelën e jurisprudencës (shih shtojcën 6) Paneli ka paraqitur qëndrimin e tij rreth disa çështjeve procedurale.

a. Propozimi për zbatimin e masave të përkohshme nga EULEX-i

Paneli për të parën herë i ka propozuar ShM-së që t'i zbatoj masat e përkohshme në përputhje me dispozitat e Rregullës 22 të rregullores së vet të punës. Në *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012, ankuesi ka pohuar se EULEX-i ka shkelur të drejtën e tij të KEDNj-së atëherë kur deklaratat e tij ia ka dërguar autoriteteve në Serbi, kundër vullnetit të tij. Ai ka deklaruar se ndihet i kërcënuar, pasi emri i tij i ishte zbuluar autoriteteve serbe, të cilëve ai nuk iu besonte.

Pa i paragjykuar meritat e lëndës, Paneli ka shpallur këtë lëndë të pranueshme. Gjithashtu, Paneli i ka propozuar ShM-së që të ftohen prokurorët e EULEX-it, të cilëve iu është caktuar kjo lëndë, t'ju kërkojnë kolegëve të tyre serbë t'ju kthejnë kopjet e secilit dokument që ju është dhënë, ku përmban emrin po përmendet emri i ankuesit. Ky propozim përfshinte të dy deklaratat që ju ishin ofruar EULEX-it nga ankuesi.

Për më tepër, Paneli ka propozuar se prokurorëve të EULEX-it në fjalë t'ju kërkohet që të kërkojnë nga kolegët e tyre serb si në vijim:

- i. T'i asgjësojnë kopjet e dokumenteve të përmendura më lart dhe ta korrigjojnë emrin dhe të dhënat e ankuesit në dokumentet e tjera, të cilat mund të shpijnë drejt identifikimit të ankuesit; dhe
- ii. Të lajmërohen prokurorët e EULEX-it se kjo është realizuar, dhe
- iii. Mos t'i zbulohet ndonjë të dyshuari asnjë informatë që është i është dhënë EULEX-it nga ankuesi.

Paneli do të shpërndaj vendimin e tij në lidhje me meritat e lëndës gjatë vitit 2013.

5.3. Meritat

a. Nuk ka shkelje të nenit 2 dhe nenit 8

Në lëndën *Y. kundër EULEX-it*, ankuesi pretendon se veprimet dhe mos veprimet e EULEX-it kanë shkelur nenin 2 të KEDNj-së që mbron të drejtën për jetë si dhe nenin 8, të drejtën për jetë private dhe familjare. Për shembull, një ish pjesëtar i EULEX-it ka pohuar se siguria e tij dhe e familjes së tij ishin vënë në rrezik nga veprimet e prokurorit të EULEX-it, i cili nuk e kishte trajtuar siç duhej çështjen e tij të sigurisë si dëshmitar i mundshëm i rastit. Një prej shkaqeve kryesore për shqetësim nga ana e ankuesit ishte se identiteti i tij supozohej se ishte zbuluar nga një artikull i një gazete ndërkombëtare rreth të së ashtuquajturit rasti "Medicus", i cili i referohej trafikimit të organeve në Kosovë.

Paneli përsërit faktin se "fjalja e parë e nenit 2 e KEDNj-së urdhëron autoritetet që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, mirëpo gjithashtu edhe të marrin hapa të duhur për të ruajtur jetët e atyre të cilët hyjnë nën kompetencat e tij (shih, në mes të tjerash autoritetet, *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, paragrafi 36, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-III).

Ngjashëm, objektivi kryesor i nenit 8 të KEDNj-së është që të mbroj individin nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike. Çfarëdo ndërhyrje e tillë sipas nenit 8.1 duhet të arsyetohet sipas përjashtimeve të renditura në nenin 8.2, ndër të tjera, duke qenë “në përputhje me ligjin” dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të GjEDNj-së, nocioni i nevojës nënkupton se ndërhyrja korrespondon me një nevojë të ngutshme sociale dhe në veçanti se është në proporcion me një prej qëllimeve që ndiqen nga autoritetet (shih në mesin e shumë autoriteteve të tjera *Olsson kundër Suedisë* (Nr. 1), 24 mars 1988, § 67, Seria A nr. 130). Përveç kësaj, mund të ketë gjithashtu edhe obligime pozitive të qenësishme në “respektimin” efektiv të jetës private. Këto obligime mund të përfshijnë miratimin e masave të hartuara për të siguruar respektin për jetën private dhe familjare edhe në sferën e marrëdhënieve midis individëve, përfshirë zbatimin, aty ku është e nevojshme, të masave të veçanta (shih në mesin e autoriteteve të tjera *X dhe Y kundër Hollandës*, 26 mars 1985, § 23, Seria A nr. 91).”

Paneli më tej ka deklaruar se “[në] këtë lëndë, për aq sa ankuesi pretendon se janë zbuluar informatat që gjenden në atë artikull, e që rezultojnë prej veprimeve apo mosveprimeve të EULEX-it, Paneli vëren se asnjë provë nuk është paraqitur për të treguar se ndonjë informatë e paraqitur tek prokurorët e EULEX-it nga ankuesi i ishte dhënë ndonjë pale të tretë duke shkelur të drejtën e tij. Nuk është treguar as edhe se ka pasur rrjedhje të informatave konfidenciale në lidhje me identitetin e ankuesit që mund t’i ngarkojë EULEX-it. Në secilën rrethanë, Paneli vëren se artikulli i kontestuar rreth “rastit Medikus” i referohet ankuesit dhe ngjarjeve të vitit 2008 vetëm në një mënyrë të përgjithësuar. Artikulli nuk ka përmbajtur ndonjë informatë të hollësishme që do të lejonte dikë të vërtetojë apo të rrezikojë zbulimin e identitetit të individit, i cili kishte qenë dëshmitar në rrëzimin e dyshuar të viktimës në aeroportin e Prishtinës. Për më tepër, ankuesi nuk ka arritur të përmendë asnjë rrethanë apo fakt që do të lejonte dikë të pranojë se pala e tretë e kishte identifikuar atë në bazë të artikullit të kontestuar apo se kishte pasur ndonjë kërcënim ndaj tij.

Prandaj, Paneli nuk mund të pranojë se informata e paraqitur në atë artikull kishte dalë nga EULEX-i dhe se kishte përbërë shkelje të së drejtës së ankuesit dhe se kishte vënë në pah mungesën e respektit të jetës së tij private dhe familjare sipas kuptimit të nenit 8 të KEDNj-së, e leje më lidhur me të drejtën e tij dhe të familjes së tij për jetë, të mbrojtur me nenin 2”.

6. Çështjet operative/administrative/të personelit

6.1. Fushata informuese

Koncepti Dokumenti mbi Llogaridhënie i datës 29 tetor 2009, ndër të tjera, deklaron në Paragrafin E, se

“...EULEX-i në Kosovë do të sigurojë shpërndarjen e duhur të informatave publike rreth Panelit dhe punës së tij...”

Komandanti i Operacioneve Civile deklaroi në Paragrafin 3 të Udhëzimit të tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin se “Udhërrëfyesi” për Planifikimin Civil dhe Mundësi Operacionale duhet të përfshijë, ndër të tjerash, “përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse në publik”.

Rrjedhimisht, Paneli siç përshkruhet në këtë raport më lart është angazhuar në kryerjen e një fushate të gjerë informuese që prej qershorit të vitit 2010 për të njoftuar publikun e gjerë rreth Panelit. Kjo fushatë ka qenë mjaft efikase në rritjen e njohjes së Panelit, veçanërisht në zonat urbane, aty ku EULEX-i është i përqendruar më shumë.

Sidoqoftë, përkundër përpjekjeve të mëdha nga Paneli, ende ekziston një mungesë e njohjes së Panelit dhe mandatit dhe punës së tij tek popullata në përgjithësi, në disa zona urbane e rurale. Prandaj është menduar që një transmetim i një reklame në televizion dhe radio në vitin 2013 do ta ndihmonte Panelin që të arrij tek popullsia më e gjerë urbane e rurale, në veçanti në pjesët më të thella të Kosovës.

6.2. Papranueshmëria e ankesave

Si në vitin paraprak, Paneli ka konstatuar se një përqindje e lartë e ankesave janë shpallur të papranueshme. Këto ankesa ndër të tjera përmbajnë mangësitë të shënuara në vijim: ankesat kanë qenë haptas të pabazuara në kuptimin se ato nuk kanë parashtruar prova *prima facie* (të atypëratyshëm) rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut; ankesat janë parashtruar pas skadimit të afatit të përcaktuar me Rregulloren e Punës, dhe ato gjithashtu nuk janë përputhur në aspektin *ratione temporis* me Rregulloren e Punës, pasi ato kanë përmendur ngjarjet që kishin ndodhur para themelimit të Panelit.

Mund të vihet re se ankuesit shumë rrallë përfaqësohen nga avokatë, dhe duket se ankuesit shpeshherë e cilësojnë Panelin si organ ku drejtohen atëherë kur të gjitha mjete e tjera ligjore të jenë shterrur. Gjithashtu mund të jetë që ankuesit kanë shfryer zhgënjimin e tyre nganjëherë sa i përket ritmin tejet të ngadalshëm të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës.

Gjatë fushatës informuese në vitin 2013, Paneli do të kërkoj t’ju qaset këtyre çështjeve dhe mangësive me një theks të veçantë në ofrimin e informatave lidhur me kriteret për pranueshmërinë e ankesave.

6.3. Çështjet e personelit

Njëra prej zyrtareve ligjore të Panelit ka dhënë dorëheqje më 6 dhjetor 2011, kurse Sekretariati ka zhvilluar së fundi intervista për plotësimin e këtij vendi të punës. Në mesin e kandidatëve, ishte vetëm një kandidat i mundshëm i dërguar, kështu që Sekretariati ishte i detyruar që t’i intervistonte kandidatët e mundshëm të kontraktuar, duke shpresuar se pozita e kontraktuar mund të ofrohet nga EULEX-i.

Kështu mungesa e pozitive të kontraktuara për punësimin e stafit në Panel vazhdon të paraqes vështirësi të vazhdueshme për Panelin gjatë këtij procesi sa i përket punësimit të

një zyrtari tjetër ligjor. Kjo çështje lidhur me personelin ishte një prej problemeve të përgjithshme, të cilat ishin vënë në pah në forume të ndryshme sa i përket funksionimit të misionit, që EULEX-i në Kosovë parapëlqen personel që transferohet në EULEX sesa që parapëlqen personel të kontraktuar.²

6.4. Buxheti

Paneli nuk ka ndonjë buxhet të dedikuar për vete dhe kështu sa i përket kësaj është plotësisht i varur prej sistemit buxhetor të EULEX-it. Kjo mënyrë nuk ka penguar në mënyrë të shprehur punën e Panelit në baza ditore gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, më shumë liri veprimi në buxhet, për shembull do të mundësojë Panelit të marrë vendime të veta thjesht lidhur me çështjet administrative, si p.sh. zgjerimi i fushatës informuese, në veçanti fillimi i transmetimit në TV/radio, pa ju drejtuar EULEX-it në Kosovë.

Përveç kësaj, Paneli është shumë i kënaqur me kategoritë e ndryshme të mbështetjes që ofrohen nga EULEX-i, mirëpo duhet të ritheksohet se qasja në burimet e veta buxhetore gjithashtu do ta rriste pavarësinë e tanishme dhe atë të perceptuar të Panelit.

Paneli dëshiron të shfrytëzoj këtë mundësi që të falënderohet sa i përket bashkëpunimit të shkëlqyeshëm, mbështetjes dhe ndihmës administrative që ka pranuar nga EULEX-i në Kosovë dhe në veçanti nga Zyra për çështje Gjimore dhe të Drejta të Njeriut, ndër të tjera përmes së cilës Paneli komunikon dhe bashkëvepron në mënyrë efektive me EULEX-in në Kosovë.

7. Komente ndërkombëtare rreth Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka qenë subjekt i komenteve ndërkombëtare, në çështje të ndryshme gjatë periudhës raportuese. Artikulli “Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut: Mekanizëm Unik Llogaridhënës i EULEX-it”, shkruar nga znj. Mariya C. Nikolova, studente në shkollën e doktoratës ka qenë me një rëndësi të veçantë.

Pas paraqitjes së mandatit, procedurave dhe praktikës gjyqësore të Panelit, znj. Nikolova vazhdoj të diskutoj, ndër të tjera, punën e Panelit, përparësitë dhe me gjasë sfidat që e presin në të ardhmen. Ajo vuri në dukje se përderisa Paneli nuk ka qenë në gjendje që të rekomandoj ofrimin e kompensimit, ky mekanizëm ka përfaqësuar një forum shumë të nevojshëm që të ofroj korrigjim për shkeljet, të cilat ndryshe do të mbetnin të pa trajtuara. Themelimi i tij gjithashtu përfaqëson një riafirmim konkret të kushtit që organizatat ndërkombëtare gjatë ushtrimit të kompetencave ekzekutive gjithashtu do të kenë përgjegjësi për të drejtat e njeriut dhe se viktimat kanë të drejtë t’ju drejtohen drejtësisë për shkeljet që i ngarkohen atyre organizatave.

² Prandaj, shih gjithashtu Raportin Special nr. 18 nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, faqe 38, pika 89 nën <http://eca.europa.eu/portal/pls/portal/docs/1/17766744.PDF>

7.1. Përparësitë e Panelit

Gjatë përmbledhjes së përparësive të Panelit nga ana e autores, ajo së pari ka deklaruar se pothuajse vetëm për faktin se Paneli ekziston, ai po sjell një shkallë të transparencës në punën e EULEX-it, e që ishte e paparë tek misionet e tjera të BE-së dhe të KB-së nëpër botë. Prandaj, Paneli përfaqëson jo vetëm një forum të rëndësishëm për korrigjimin e shkeljeve, mirëpo ai shërben edhe si mekanizëm për vetë-rregullim dhe përmirësim brenda vetë pranisë së EULEX-it.

Së dyti, autorja ishte e mendimit se Paneli tashmë kishte mbajtur premtimin për të ofruar konstatime konkrete të arsyeshme dhe se kishte kryer punën e vet në mënyrë të shpejtë dhe të paanshme.

Së treti, ajo tha se gjatë fushatës informuese të Panelit, Paneli nuk i ofron shoqërisë civile dhe zyrtarëve publik thjeshtë vetëm informata rreth mandatit, procedurave dhe punës së vet. Paneli gjithashtu ka kërkuar që të kultivoj sensibilizim të përgjithshëm rreth të drejtave themelore të njeriut dhe mekanizmave për korrigjim. Kjo nismë nga ana tjetër i ka shërbyer objektivit edukativ të riafirmimit të vlerës dhe besimit në sundimin e ligjit. Ajo ka thënë se kjo mënyrë vetëm se do ta afirmoj edhe më tutje objektivin kryesor të EULEX-it në Kosovë.

7.2. Sfidat për Panelin

Autorja ishte e mendimit se ka qenë e parakohshme për të bërë ndonjë paragjykim apo për të nxjerrë ndonjë përfundim rreth efikasitetit të punës së Panelit dhe se ajo ka përshkruar disa sfida me të cilat është ballafaquar Paneli.

Së pari, ky mekanizëm llogaridhënës tani merr fondet e tij plotësisht nga EULEX-i. Sidoqoftë, pavarësia e vërtetë dhe ajo e perceptuar mund që vijë vetëm me një buxhet burimor të pavarur. Ajo ka thënë se mbetet e hapur çështja nëse EULEX-i do të kërkojë mënyrat për të arritur tek një pavarësi e tillë për Panelin.

Së dyti, me zhvillimin e praktikës gjyqësore të Panelit, ndoshta do të ketë më shumë qartësi sa i përket kuptimit dhe qëllimit të saktë të termit “mandati ekzekutiv” i EULEX-it, i cili e përcakton fushëveprimin e kompetencave të Panelit. Të dhënat e tanishme vënë në pah një qasje mjaft të kujdesshme, mirëpo do të jetë e rëndësishme për Panelin që të shihet jo vetëm si mekanizëm që thjesht ruan apo shfajëson EULEX-it nga përgjegjësia, duke përdorur një interpretim formal të termit “mandati ekzekutiv”.

Së treti, mbetet të shihet se si Paneli do të përpiqet t’ju shpjegojë viktimave se nuk ka kompetenca për të rekomanduar dhënien e kompensimit financiar për dëmet e shkaktuara apo për të lëshuar vendime detyruese. Deri më tani këtë e ka bërë në mënyrë efektive gjatë fushatës informuese, mirëpo duhet të ketë përpjekje të përbashkët nga Paneli për të treguar se gjetjet dhe rekomandimet që ata marrin shërbejnë vetëm si një mjet i rëndësishëm për të ofruar përmirësime dhe korrigjime si çdo kompensim material, i cili mund t’i ofrohet ankuesit.

Së katërti, sa i përket fushatës informuese, ajo ka thënë se sfidat do të vazhdojnë rreth informimit të autoriteteve publike dhe shoqërisë civile rreth detyrave dhe kompetencave të sakta të Panelit dhe parandalimin e një rritje të shpejtë të ankesave të papranueshme për shkak të mungesës së njohjes së mandatit të tij nga ana e qytetarëve.

7.3. Përfundim

Autorja së parë ka thënë se Paneli mund të shndërrohet në një mekanizëm unik që siguron një rezultat më të mirë nga ana e EULEX-it dhe kontribuon në mësimet e nxjerra për misionet e ardhshme të BE-së. Sigurisht, ky propozim do të jetë i kushtëzuar prej vendimeve të ardhshme rreth personelit, burimeve dhe financave të PShDNj-së, si dhe varësisht prej nivelit që shihet se sa EULEX-i mundëson zbatimin e vendimeve të lëshuara nga PShDNj-ja dhe se sa janë zbatuar masave efektive korigjuese.

Së dyti, edhe pse është shumë herët të gjykohet ndikimi i Panelit, treguesit përfshijnë përshtatshmërinë dhe transparencën e gjetjeve, nivelin e përfshirjes së shoqërisë civile, bashkëpunimin me shëfën e Misionit të EULEX-it, dhe zbatimin e rekomandimeve. Mirëpo duke treguar se është i gatshëm që t'iu nënshtrohet një shkalle të përgjegjësisë sa i përket të drejtave të njeriut, EULEX-i tashmë ka ecur në drejtimin e duhur.

Për më tepër, nuk duhet të harrohet se ekzistojnë shumë mënyra të tjera të ngjashme për të ofruar përgjegjësi. Sidomos, përgjegjësia ligjore duhet të sigurohet në rend të parë nga mekanizmat gjyqësorë të shteteve pjesëmarrëse të BE-së.

Autorja ka përfunduar duke thënë se koncepti që qëndron pas Panelit nuk ka qenë vetëm që të riafirmoj angazhimin e EULEX-it në respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, mirëpo gjithashtu që të nxis një kulturë llogaridhënëse tek autoritetet kosovare. Nëse do të jetë apo nuk do të jetë në gjendje që të bëjë këtë në mënyrë efektive, do të varet nga niveli i pavarësisë së vërtetë që arrin të marrë nga buxheti i EULEX-it, mënyrë e cila përcakton fushëveprimin e kompetencave të tij, dhe shkallën në të cilën EULEX-i i zbaton rekomandimet e tij.

[Shih shtojcën nr. 4. Artikulli](#)

8. E ardhmja e EULEX-it dhe sfidat rreth të drejtave të njeriut në të ardhmen

Ristrukturimi i fundit i EULEX-it në Kosovë ngrit disa shqetësime që lidhen me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Paneli ka identifikuar se çështjet më të ngutshme për tu shqyrtuar nga BE-ja dhe udhëheqësia e EULEX-it në kontekst të këtij procesi janë këto si në vijim:

i. Në këtë moment, bartja e vendimmarrjeve gjyqësore tek trupi i gjykatësve të përbërë nga shumica e vendorëve e jo tek gjykatësit e EULEX-it mund të ngreh probleme serioze të shfaqjes së mungesës së paanësisë tek gjyqësori në disa komunitete të prekura.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli mendon se kjo çështje duhet të mbetet për t'u shqyrtuar sa i përket lëndëve të ndjeshme (siç janë lëndët e krimeve të luftës, lëndët e krimeve të organizuara, apo lëndët ku gjykatësit dhe palët janë me përkatësi të ndryshme etnike), kështu që, aty ku është nevoja EULEX-i në Kosovë mund të ushtroj diskrecionin e vet për të siguruar që shumica e gjykatësve të EULEX-it do të vendosin rreth atyre lëndëve. Ne pohojmë se kjo do të ndihmoj në përfundimin e besimit tek të gjithë komunitetet përkatëse sa i përket paanshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit. Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje mundësisë për një qasje më aktive nga ana e EULEX-it në Kosovë lidhur me marrjen përsipër të lëndëve që janë të pazgjidhura pranë gjykatave të Kosovës nga trupi gjykues i përbërë plotësisht apo pjesërisht nga gjykatës të EULEX-it.

ii. Ndërprerja e aktiviteteve të drejtpërdrejta të mentorimit, monitorimit dhe këshillimit (MMK) që janë kryer në takime mes dy personave apo qasjeve të tjera individuale ka ngritur shqetësime rreth nevojës për të siguruar bartjen e duhur të kompetencave nga gjykatësit dhe ekspertët e EULEX-it tek gjyqësori vendor para reduktimit dhe tërheqjes graduale të aktiviteteve të MMK-së. Tërheqja e parakohshme e këtyre përgjegjësive nga EULEX-i mund të ndikoj në kapacitetin e gjyqësorit vendor për të vepruar në mënyrë të vazhdueshme sipas standardeve të të drejtave të njeriut të zbatueshëm në Kosovë, në veçanti sa i përket procedurave gjyqësore.

iii. Çështjet e mësipërme janë ngritur në kontekst të mungesës së mbështetjes ligjore nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatat e Kosovës. Kjo thekson nevojën që EULEX-i të siguroj se standardet e larta të paansisë procedurale respektohen nëpër gjithë gjyqësorin në Kosovë. Qasja efektive në drejtësi nga të gjithë individët që i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave të Kosovës duhet të vazhdojnë të jetë me prioritet për EULEX-in në Kosovë. Përkrahja efektive dhe zbatimi i standardeve të tilla do të zbuste shqetësimet që lidhen me jo efikasitetin e tanishëm të disa prej mjeteve ekzistuese të mjeteve korrigjuese në Kosovë.

iv. Reduktimi i burimeve të ndara për aspektet gjyqësore të misionit të EULEX-it mund që të ndikoj negativisht në kohëzgjatjen e procedurave dhe cilësinë e drejtësisë. Nga ana tjetër, kjo mund të ndikoj negativisht në të drejtat e palëve gjyqësore dhe të pandehurve në Kosovë, në veçanti në të drejtat e tyre për zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë të lëndëve. EULEX-i në Kosovë duhet të jetë vigjilent sa i përket kërkesës për të ruajtur nivelet përkatëse (financiare dhe të tjera) kështu që të siguroj se drejtësia dhe cilësia e procedurave gjyqësore në Kosovë nuk preken negativisht nga ristrukturimi dhe reduktimi i EULEX-it.

v. EULEX- gjithashtu duhet që të siguroj se angazhimi i shteteve anëtare të BE-së, dhe si rrjedhojë angazhimi i vet për të mbështetur të drejtat e njeriut ndërkombëtarisht të njohura të zbatueshme në Kosovë nuk është thjesht formalitet apo premtim, por është i vërtetë, konkret dhe efektiv. Prandaj, Paneli konsideron se EULEX-i duhet të mbetet plotësisht i angazhuar në përkrahjen e respektimit të të drejtave të njeriut në gjithë gamën e aktiviteteve të ndërmarra nga EULEX-i.

vi. Paneli është i mendimit se promovimi i njohjes së të drejtave të njeriut në gjithë misionin e EULEX-it duhet që të vazhdoj në mënyrë aktive. Në këtë drejtim, dukja e pamjaftueshme e Panelit në gjithë ristrukturimin e EULEX-it, siç paraqitet, ndër të tjera, me

faktin se informatat rreth mandatit dhe rolit të Panelit ishin hequr nga trajnimi hyrës për personelin e ri për një periudhë mjaft të gjatë është për të ardhur keq. Kjo nuk përputhet me qëllimin e përgjithshëm të nxitjes së njohjes së të drejtave të njeriut tek pjesëtarët e Misionit. Të drejtat e njeriut përbëjnë një element të qenësishëm të sundimit të ligjit dhe të personelit të Misionit, të cilët vijnë prej shteteve dhe përvojave të ndryshme e që duhet të jetë të njohura me to, apo nëse është nevoja të të njoftohen me to. Paneli fton EULEX-in që në këtë kontekst të rishqyrtoj rolin e Panelit dhe gjatë trajnimit të personelit të vë theksin më shumë në aspektet e të drejtave të njeriut. Pjesëtarët e personelit me prejardhje dhe kombësi të ndryshme shpesh kanë botëkuptime të ndryshme se si ju qasen çështjeve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, roli unik që ka EULEX-i për shkak të kompetencave të tij ekzekutive dhe funksioneve të fuqizimit kërkojnë një qasje të përbashkët në obligimet e EULEX-it rreth të drejtave të njeriut.

Përveç elementit ekzistues të të drejtave të njeriut që është vendosur së fundi në trajtimin hyrës për pjesëtarët e rinjë të misionit, si dhe elementet e rëndësishme të të drejtave të njeriut brenda trajnimit të tanishëm për Përdorimin e Forcës, Paneli fton EULEX-in që të konsideroj përfshirjen e trajnimit, e përshtatshme posaçërisht për sektorët/njësitë përkatëse të EULEX-it, sipas nevojave të tyre, që përbëjnë Divizionin Ekzekutiv dhe Divizionin e Fuqizim.

vii. Prandaj, Paneli fton EULEX-in të konsideroj mënyrat më të mira për të promovuar dhe mbështetur zbatimin efektiv juridik të standardeve ndërkombëtarisht të njohura. Në këtë kontekst, Paneli më tej fton EULEX-in të konsideroj mundësinë e diskutimit me autoritetet kompetente të Kosovës krijimin e një dhome të re të të drejtave të njeriut, brenda apo jashtë strukturës ekzistuese gjyqësore, për të përforcuar nevojën e mbikëqyrjes së të drejtave të njeriut ndaj vendimeve dhe aktiviteteve të gjykatave më të ulëta të Kosovës. Duke marrë parasysh mungesën e tanishme të mundësisë për qytetarët e Kosovës që të parashtrajnë ankesë tek Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Paneli propozon që EULEX-i duhet të konsideroj mënyrat për të përforcuar dhe mbështetur përpjekjet gjyqësore në mënyrë që të siguroj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Disa prej shqetësimeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut lidhen me atë çfarë u tha më lart (*dhe të tjerat* që përmenden aty) janë pasqyruar në disa prej raporteve të pavarura të botuara në vitin 2012, (shih posaçërisht Raportin e Gjykatës Evropiane të Auditorëve “Asistenca e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë”; dhe KIPRED-i “Një analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?”). Komentet kritike të bëra në këto raporte duhet të merren seriozisht dhe të trajtohen si çështje urgjente, veçanërisht aty ku përfshihen çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

9. Komentet përmbyllëse

9.1 Përfundimet

Paneli tani ka përfunduar vitin e tretë të punës. Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka zhvilluar katër seanca përveç takimit me Grupin Punues të Komisionit për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave të Bashkimit Evropian (CIVCOM) në Bruksel. Është vërejtur një rritje e

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

e konsiderueshme e lëndëve, ku janë pranuar njëzet e tre ankesa të reja. Paneli ka trajtuar shtatëmbëdhjetë ankesa gjatë kësaj periudhe raportuese; një përqindje shumë e lartë e këtyre ankesave janë gjetur të papranueshme.

Paneli ka vazhduar me zbatimin e fushatës informuese në forma të ndryshme. Sidoqoftë, duhet të nënvizohet se përkundër përpjekjeve të mëdha të tij, ekziston një mungesë shqetësuese e njohjes së Panelit, mandatit dhe procedurave të tij në një zonë të gjerë ku vepron misioni. Paneli beson se këtij hendeku mund t'ju qaset, ndër të tjera, me një fushatë të gjerë përmes TV-së dhe radios, që shpresohet që të filloj në vitin 2013 së bashku me një intensifikim të aktiviteteve të rregullta të fushatës informues që është në vazhdim e sipër. Në këtë pikë kritike, tashmë duke e ditur pasi që ka ndodhur, për Panelin është e qartë se zbatimi efektiv i fushatës informuese në një vend që ka dalë nga konflikti është detyra më e vështirë, e cila kërkon burime të konsiderueshme njerëzore dhe materiale.

Ka pasur mjaft ndryshime në përbërjen e Panelit gjatë periudhës raportuese, pra pas dorëheqjes së Kryesuesit të Panelit dhe dy anëtarëve të Panelit që vinin nga EULEX-i. Që të dy anëtarët e Panelit që vinin nga EULEX-i janë zëvendësuar përmes një konkursi përzgjedhës të EULEX-it, ndërsa një anëtar i jashtëm ngjashëm ishte punësuar për të plotësuar vendin e lirë të punës, që ishte krijuar pas largimit të kryesuesit të Panelit. Gjithashtu ka pasur disa ndryshime në Sekretariatit e Panelit me dorëheqjen e dy zyrtarëve ligjore, të cilat ishin zëvendësuar me kohë pas pranimit të dy zyrtarëve të rinj ligjorë. Me vetëm një anëtar që shërben që nga fillimi i punës së Panelit në vitin 2010, znj. Magda Mierzewska në cilësinë e kryesueses, Paneli është përballur me vështirësi të njëjta strukturore, si ato të përshkruara nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, e cila ndër të tjera ia vështirëson EULEX-it që të zhvilloj dhe ruaj kujtesën institucionale. Paneli ka bërë çdo përpjekje për t'u përballur me këtë sfidë.

9.2 Rekomandime

1. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i t'ju qasen në mënyrë urgjente kërkesave të Panelit për ta lehtësuar zgjerimin e konsiderueshëm të fushatës së tij informuese, në veçanti futjen dhe nisjen e transmetimeve në TV dhe radio.
2. Paneli rekomandon që të ndiqet në mënyrë aktive synimi për një njohje më të madhe të të drejtave të njeriut në kuadër të misionit të EULEX-it. Në këtë kontest, Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të këmbëngulin dhe të sigurojnë se mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut në Kosovë është, dhe jo vetëm se mbetet, një çështje me prioritet në kontekst të trajnimit të personelit të ri të EULEX-it, por edhe që të zgjerohet më tutje tek divizionet dhe njësitë përkatëse të EULEX-it në mënyrë që të sigurohet një njohje e përgjithshme nga personeli i EULEX-it i obligimeve të EULEX-it ndaj të drejtave të njeriut.
3. Paneli rekomandon që EULEX-i duhet të merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se i tërë personeli i EULEX-it është i njohur me nevojën për të respektuar standardet themelore të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Në veçanti, EULEX-i duhet të përpiqet që t'i përdor të gjitha mekanizmat e nevojshëm

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

dhe të ndaj mjete të nevojshme për t'u marrë në mënyrë të shpejtë dhe efektive me kërkesat e Panelit për informata lidhur me ankesat e parashtruara në Panel.

4. Paneli rekomandon që për BE-në dhe EULEX-in respekti për të drejtat e njeriut të jetë çështje me prioritet gjatë strategjisë së largimit shkallë shkallë, dhe gjithashtu që të sigurohen se që të zbatohen të gjitha procedurat dhe mekanizmat e nevojshëm për të garantuar dhe mbrojtur këto të drejta, atëherë kur EULEX-i të ketë përfunduar mandatin e tij. Në veçanti, Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të vazhdojnë dialogun me autoritetet kompetente të Kosovës gjatë strategjisë së tyre afat mesme dhe afat gjate sa i përket mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut në Kosovë, në veçanti të drejtave të pakicave. Paneli gjithashtu rekomandon që qasja efektive në drejtësi nga të gjithë individët, të cilët janë subjekt i juridiksionit të gjykatave në Kosovë, të jetë vazhdimisht çështje me prioritet për EULEX-in pasi t'i ndërpresë operacionet e veta në Kosovë.
5. Paneli rekomandon që tranzicioni në gjykatat e Kosovës, në veçanti në fushat e ndjeshme (siç janë: krimi i organizuar; lëndët e korrupsionit; lëndët pronësore; lëndët e krimeve të luftës; lëndët e korrupsionit; lëndët rreth të drejtave të njeriut) nga trupi gjykues në përbërje prej shumicës së gjykatësve të EULEX-it në një trup gjykues në përbërje prej një shumice të gjykatësve të Kosovës të mbetet për t'u shqyrtuar në mënyrë të kujdesshme, kështu që nëse është e nevojshme EULEX-i të mund të veprojnë sipas diskrecionit të tij për të siguruar se shumica e gjykatësve të EULEX-it do të vendosin rreth lëndëve, të cilat janë më të ndjeshme.
6. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i duhet të sigurojnë se heqja e MMK-së, e cila bazohet në takime të drejtpërdrejta mes dy personave apo qasjeve të tjera individuale nuk duhet ta pengoj nevojën e bartjes së kompetencave tek akterët vendorë dhe ndërtimin e kapaciteteve të akterëve vendorë në fushën e të drejtave të njeriut.
7. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të jenë të kujdesshëm rreth nevojës për të ruajtur nivelet e duhura të burimeve përkatëse (financiare dhe të tjera), në mënyrë që paanësia dhe cilësia e procedurave gjyqësore në Kosovë të mos preket negativisht nga restrukturimi, reduktimi dhe tërheqja eventuale e EULEX-it.
8. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-it të sigurojnë që zotimi i shteteve anëtare të BE-së dhe rrjedhimisht zotimi i vet atyre për të mbështetur standardet e të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht e të zbatueshme në Kosovë të jetë i vërtetë, konkret dhe efektiv. Paneli rekomandon që EULEX-i të mbetet i angazhuar plotësisht në përkrahjen e respektimit të të drejtave të njeriut përmes të gjitha fushave të aktiviteteve që ndërmerren nga EULEX-i.

Për më shumë informata rreth Panelit vizitoni www.hrrp.eu.

SHTOJCA 1 Tabela e personelit

Paneli	
Antonio Balsamo	Kryesues i Panelit 4 maj 2010 deri më 2 maj 2012
Magda Mierzewska	Anëtare e Panelit Nga 4 maj 2012 Kryesuese e Panelit Nga 4 tetori 2012
Verginia Micheva Ruseva	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it Nga 28 qershor 2011 deri më 11 janar 2012 Anëtare e Panelit Nga 12 janari 2012
Guenael Mettraux	Anëtare e Panelit Nga 1 tetori 2012
Katja Dominik	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it Nga 12 janar 2012

Sekretariati	
John J. Ryan	Zyrtar i lartë ligjor
Leena Leikas	Zyrtar ligjor Nga 17 maj 2010 deri më 16 maj 2012
Stephanie Selg	Zyrtar ligjor Nga 6 qershor – 31 dhjetor 2011
Joanna Marszalik	Zyrtare ligjore
Florian Razesberger	Zyrtar ligjor
Shpresa Gosalci	Asistente administrative/gjuhësore (shqip-anglisht)
Katica Kovaceviç	Inteprete/përkthyes (serbisht-anglisht)
Kushtrim Xhaferi	Interpret/përkthyes (shqip-anglisht)

SHTOJCA 2 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Fushata informuese dhe aktivitetet e tjera për vitin 2012

Data	Vendi	Ngjarja	Paneli	Sekretariati	Organizata
09/03/12	Hotel Prishtina	Seminar i UNDP-së		John Ryan	UNDP
19/03/12	Restorant Rroni	Takimi me shefin e Misionit (ShM i EULEX-it-Kosovë)	Antonio Balsamo Magdalena Mierzewska Verginia Micheva-Ruseva	John Ryan Leena Leikas	PShDNj
19/03/12	PShDNj	Studentët e programit evropian të masterit – Qendra ndër universitare për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, Venedik	Antonio Balsamo Magdalena Mierzewska Verginia Micheva-Ruseva	John Ryan Leena Leikas	PShDNj
20/03/12	PShDNj	Takim me z. Joel Mermet, shef i UN OHCHR në Kosovë	Antonio Balsamo Magdalena Mierzewska Verginia Micheva-Ruseva	John Ryan Leena Leikas	PShDNj
29/03/12	Komuna e Graçanicës	Takim me zyrtarin ndërlidhës komunal		John Ryan Katica Kovaceviç	PShDNj
07/05/12	Bruksel	Takim mes Panelit dhe Komisionit e Bashkimit Evropian për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave (CIVCOM)	Magdalena Mierzewska	John Ryan	PShDNj /BE
22/05/12	Hotel Emerald	Seminar, Drejtësia tranzicionele		John Ryan	
04/06/12	Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian	Takim me z. Samuel Zbogar, përfaqësues special i BE-së	Magdalena Mierzewska Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszalik	PShDNj
19/06/12	Restorant Tiffanys	Qendra Juridike e Kosovës (QJK), Botime juridike		John Ryan	Qendra Juridike e Kosovës
20/06/12	Zyra e Avokatit të Popullit	Takim me z. Sami Kurteshin, Avokat i Popullit i Kosovës		John Ryan	PShDNj
29/06/12	Hotel Prishtina	Seminar - Të drejtat e personave me hendikep mendor		John Ryan	
05/07/12	Graçanicë	Takim me Rrjetin Strategjik Aksionar Kosovar (KPAN)		John Ryan Katica Kovaceviç	PShDNj
12/07/12	Graçanicë	Takim me Rrjetin Strategjik Aksionar Kosovar (KPAN)		John Ryan	PShDNj

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

21/07/12	Manastiri i Graçanicës	Takim me atin Sava Smigiq		John Ryan Katica Kovacevic	PShDNj
23/07/12	Manastiri i Pejës	Takim me zëvendës peshkopin e Patriarkanës serbe		John Ryan Katica Kovacevic	PShDNj
23/07/12	Manastiri i Pejës	Takim me kryemurgeshën		John Ryan Katica Kovacevic	PShDNj
19/09/12	Manastiri i Graçanicës	Takim me atin Sava Smigiq		John Ryan Joanna Marszalik Katica Kovacevic	PShDNj
19/09/12	Komuna e Kamenicës	Takim me zyrtarët për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore - Nazmije Demolli dhe Zejnije Lenjani		John Ryan Joanna Marszalik Katica Kovacevic Kushtrim Xhaferi	PShDNj
21/09/12	Kisha shën Nikolla, Prishtinë	Takim me atin Darko Marinoviq		John Ryan Joanna Marszalik Katica Kovacevic	PShDNj
27/09/12	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me Massimo Moratin dhe Zoran Popoviq-in (Europeaid/129209/C/SER/RS)	Verginia Micheva-Ruseva	John Ryan Florian Razesberger	PShDNj
04/10/12	Graçanica	Intervistë në Kim radio	Magdalena Mierzewska	John Ryan	PShDNj
04/10/12	PShDNj	Takim me z. Nicholas Hawton, shef i zyrës për shtyp dhe informim publik	Magdalena Mierzewska Guenael Mettraux Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszalik Florian Razesberger	PShDNj
04/10/12	PShDNj	Takim me z. Peter Bach, shef i Divizionit të Fuqizimit	Magdalena Mierzewska Guenael Mettraux Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszalik Florian Razesberger	PShDNj
12/10/12	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me znj. Kristen Stec, përfaqësuese e Këshillit danez për refugjatë, Kosovë		John Ryan	PShDNj
14-15/10/12	Manastiri i Pejës	Seminar – Ballkani dhe Lindja e Mesme: A po e pasqyrojnë njëri tjetrin?		John Ryan Katica Kovacevic	EULEX-i, KFOR-i, Shefi i kishës ortodokse
24/10/12	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me Massimo Moratin (Europeaid/129209/C/SER/RS)		John Ryan Joanna Marszalik	PShDNj
13/11/12	Beograd/Serbi	Takim me Ministrinë e Drejtësisë	Magdalena Mierzewska Guenael Mettraux Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszalik Florian Razesberger Katica Kovacevic	PShDNj
13/11/12	Beograd/Serbi	Takim me zyrën për Kosovë	Magdalena Mierzewska Guenael Mettraux Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszalik Florian Razesberger Katica Kovacevic	PShDNj
13/11/12	Beograd/Serbi	Takim me Këshillin danez për	Magdalena Mierzewska	John Ryan	PShDNj

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

	bi	refugjatë, UNHCR, OJQ-të dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.	Guenaël Mettraux Verginia Micheva-Ruseva Katja Dominik	Joanna Marszałik Florian Razesberger Katica Kovaceviq	
16/11/12	Nish/Serbi	Takim me shoqatën e veteranëve serb dhe Komisionin për të Drejta të Njeriut (CHRIS)	Katja Dominik	John Ryan Joanna Marszałik Florian Razesberger Katica Kovaceviq	PShDNj
23/11/12	Hotel Sirius	Takim me z. Sami Kurteshin, Avokat i Popullit, Kosovë		John Ryan	PShDNj
23/11/12	Hotel Sirius	Seminar – Ndal dhunën ndaj grave		John Ryan Joanna Marszałik	Institucioni i Avokatit të Popullit dhe OSBE-ja
10/12/2012	Radio Televizioni i Kosovës	Debat televiziv – Respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë	Verginia Micheva-Ruseva	John Ryan	Avokati i Popullit
10/12/12	Hotel Sirius	Diskutim në tavolinë të rrumbullakët – Pjesëmarrja dhe përfshirja në të drejtat e njeriut nuk janë privilegje, po janë të drejta – Dita ndërkombëtare e të drejtave të njeriut		John Ryan Florian Razesberger	Institucioni i Avokatit të Popullit, OSBE-ja, CoE, Zyra e UNHCHR, Kosovë
13/12/12	Ndërtesa e PShDNj-së	Agne Vaicekauskaite, kandidate për doktoratë, Doktoratë rreth EULEX-in në Kosovë, Universiteti i Konstanz-ës (Gjermani)		John Ryan	PShDNj
19/12/12	Zyra për informim e BE-së në Prishtinë	ECMI, Prezantim rreth Doracakut lidhur me të drejtat e njeriut të grupeve të rrezikuara dhe marginalizuara në Kosovë		Florian Razesberger	Qendra për Informim e BE-së, Kosovë

SHTOJCA 3 Statistikat 2010 - 2012

Kohëzgjatja mesatare e procedurave në Panel është diku 180 ditë, pra gjashtë muaj.

	2010	2011	2012	Gjithsej
Lëndët e regjistruara - Gjithsej	16	28	23	67
Lëndët e përfunduara - Gjithsej	6	30	12	48
Të pranueshme			2*	2
Të papranueshme	6	22	10	38
Shkelje	0	2	0	2
Nuk ka shkelje	0	5	0	5
Të hequra në lista	0	1	0	1

*Lëndët jo të përfunduara

Statistikat	Më 31 dhjetor 2012
Në pritje	19
Të pranueshme	2
Të papranueshme	38
Shkelje	2
Nuk ka shkelje	5
Të hequra në lista	1
Lëndët e regjistruara prej qershorit të vitit 2010 – Gjithsej	67

Të përfshirë në ankesa	
Divizioni Ekzekutiv	58
Individë/ndërmarrje private	9
Gjithsej	67

SHTOJCA 4

Vendimet e PShDNj-së 2010-2012

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
1.	2010-01	Djeljalj Kazagic	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2.	2010-02	Sadik Thaqi	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
3.	2010-03	Osman Mehmetaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
4.	2010-04	Feti Demolli	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
5.	2010-05	Mursel Hasani	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
6.	2010-06	Latif Fanaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
7.	2010-07	Blerim Rudi	Dyshohet në mos zbatim të urdhit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare.	Shkelje
8.	2010-08	Delimir Krstic	Dyshohet në mos veprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
9.	2010-09	Burim Ramadani	Dyshohet në mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
10.	2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
11.	2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
12.	2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
13.	2010-13	Një punëtor i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
14.	2010-14	Lulzim Gashi	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
15.	2010-15	Faton Sefa	Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektori privat), dyshohet në mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
16.	2010-16	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i drejtë i lëndës së ankuesit nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
17.	2011-01	Familja e Dedë Gecaj	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
18.	2011-02	Chamalagai Krishna Bahadur	Dyshohet në mos veprim	E papranueshme
19.	2011-03	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
20.	2011-04	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista e ankesave
21.	2011-05	SH.P.K "Syri"	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC.	E papranueshme
22.	2011-06	Milazim Blakqori	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	E papranueshme
23.	2011-08	Anton Rruka	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC.	E papranueshme
24.	2011-09	Mirkovic Bojan	Dyshohet në largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
25.	2011-10	Dejan Jovanovic	Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave në SCSC.	E papranueshme
26.	2011-11	Srecko Martinovic	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
27.	2011-12	Novica Trajkovic	Përdorim i tepruar i forcës	E papranueshme
28.	2011-13	S.M.	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme
29.	2011-14	Lindita Shabani	Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
30.	2011-15	Samedin Smajli	Dyshohet në mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
31.	2011-16	Avdyl Smajli	Dyshohet në mohim në gjykim të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
32.	2011-17	Faik Azemi	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
33.	2011-18	Mykereme Hoxha	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
34.	2011-19	Sefer Sharku	Dyshohet në mos respektim të vendimit detyrues gjyqësor.	E papranueshme
35.	2011-21	Ventor Maznikolli	Dyshohet në vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme.	E papranueshme
36.	2011-22	Hysni Gashi	Dyshohet për mohim të një gjykimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësi të gjykatësve të EULEX-it.	E papranueshme
37.	2011-23	Hashim Rexhepi	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe së drejtës për gjykim të drejtë.	Pjesërisht e pranueshme – Nuk ka shkelje
38.	2011-24	Predrag Lazic	Dyshohet në mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.	E papranueshme
39.	2011-25	Shaip Gashi	Dyshohet në privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi.	E papranueshme
40.	2011-26	Njazi Asllani	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	E papranueshme
41.	2011-28	Case Y	Dyshohet në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.	E papranueshme
42.	2012-01	Qamil Hamiti	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
43.	2012-02	Arben Zeka	Dyshohet për mos gjykim të një lënde pronësore.	E papranueshme
44.	2012-03	Rexhep Dobruna	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
45.	2012-04	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë.	E papranueshme
46.	2012-05	Fatmir Pajaziti	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë.	E papranueshme

SHTOJCA 5 Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i Bashkimit Evropian: Mekanizëm unik llogaridhënës për EULEX-in

24 tetor 2012

nga Mariya C. Nikolova

Hyrje



Në përgjithësi misionet e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian që kanë mandat është vërejtur se i mungojnë mekanizmat e duhura llogaridhënës për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera gjatë mandatit të tyre. Një prej kritikave kryesore ka qenë se në të vërtetë viktimat e shkeljeve të tilla nuk kanë pasur qasje në një forum ku ata mund të sjellin ankesat e tyre, e që në vetvete minon qëllimet

dhe synimet e organizatave dhe shkel të drejtat e tyre për të pasur qasje në drejtësi.

Bazuar në konsultimet gjithëpërfshirëse, dhe duke marrë parasysh nevojën për të korrigjuar shkeljet e mundshme, Bashkimi Evropian ka themeluar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) në vitin 2009. PShDNj-ja është mekanizëm jo gjyqësor llogaridhënës që ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të kryera nga ana e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX-i) gjatë mandatit të tij ekzekutiv. PShDNj-ja mund të bëjë rekomandime jo detyruese në bazë të gjetjeve dhe të përcjell zbatimin e atyre rekomandimeve nga shefi i EULEX-it.

Si e tillë, PShDNj-ja plotëson mekanizmat e tjerë të tanishëm llogaridhënës në EULEX dhe është i frymëzuar prej organeve të tjera llogaridhënëse të themeluar, siç është Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut i Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK-u) dhe prej Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë.

Edhe pse disi ka mbetur pa u vënë re, PShDNj-ja premtion të shërbej si një projekt i rëndësishëm provues për llogaridhënie sa i përket çështjes së të drejtave të njeriut për misionet e ardhshme të BE-së. Siç shënon në raportin e vet vjetor, PShDNj-ja tani për tani është “mekanizmi i vetëm i këtij lloji që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të kryera nga ana e misionit për politikë të përbashkët për mbrojtje dhe siguri (CSDP) të Bashkimit Evropian”.

Përderisa, nuk është në gjendje të ofroj dëmshpërblime, ky mekanizëm përfaqëson një forum shumë të nevojshëm për të ofruar korrigjim sa i përket shkeljeve të cilat përndryshe do të mbeteshin të pazgjidhura. Konkretisht ky po ashtu e rivërteton kushtin se organizatat ndërkombëtare gjithashtu kanë përgjegjësi për të drejtat e njeriut, dhe se viktimat kanë të drejtë t’i qasen drejtësisë për shkeljet që i ngarkohen organizatave të tilla. Lidhur me këtë,

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

vërehet se Komisionari për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës tashmë në vitin 2009 ka deklaruar se:

“Askush, sidomos një organizatë ndërkombëtar, nuk është mbi ligjin [...] kur organizatat ndërkombëtare ushtrjnë kontroll ekzekutiv dhe legjislativ sikur një shtet ata duhet të obligohen përmes kontrolleve dhe vlerësimeve të njëjta siç kërkohet prej një qeverie demokratike.”

Së fundi, idea që qëndron pas PShDNj-së nuk është që vetëm të ripohoj angazhimin e vetë EULEX-it për përfilljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, mirëpo edhe për të nxitur një kulturë llogaridhënese tek autoritetet e Kosovës. Nëse do të jetë apo nuk do të jetë në gjendje që të bëjë këtë në mënyrë efektive, do të varet nga niveli i pavarësisë së vërtetë që arrin të marrë nga buxheti i EULEX-it, mënyrë e cila përcakton fushëveprimin e kompetencave të tij, dhe shkallën në të cilën EULEX-i i zbaton rekomandimet e tij.

Pjesët në vijim shqyrtojnë disa nga karakteristikat unike të PShDNj-së dhe do të ofrojë disa pasqyrime lidhur me kompetencat e sapolindura dhe sfidat që dalin përpara gjatë zbatimit të mandatit të tij.

Mandati dhe arsyetimi

PShDNj-ja ka lindur pasi është vërejtur se ka pasur një zbrazëtim në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që i ngarkohen EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij në Kosovë. Prandaj, mbi të gjitha ai është një mekanizëm llogaridhënës. Sidoqoftë, Paneli nuk ka kompetencë për të marrë vendime detyruese dhe nuk ofron ndonjë kompensim për dëmet.

Është diskutuar idea për të pasur një mekanizëm me kompetenca detyruese, apo edhe me shtrirje të kompetencave të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sa i përket veprimeve të administratës ndërkombëtare në Kosovë, ndërsa ajo ide në atë kohë ishte lënë menjane për shkak të ndërlikueshmërisë ligjore. PShDNj-ja përfaqëson një masë afatshkurtër të ndërmarrë për të përmirësuar llogaridhënien e EULEX-it. Prandaj, është e imagjinueshme që zhvillimi i mëtejshëm ligjor në të ardhmen mund të shpije drejt një lloji më të kufizuar të përgjegjësisë.

Përbërja, personeli dhe fondet



Magda Mierzevska, Kryesuese e Panelit

PShDNj-ja përbëhet nga tre gjykatës ndërkombëtarë, njëri prej të cilëve është gjykatës i EULEX-it. Të gjithë ata janë të emëruar për një periudhë një vjeçare nga shefi i Misionit të EULEX-it, bazuar në një proces përzgjedhës konkurrues, dhe se ata në asnjë mënyrë nuk i përgjigjen atij. Gjykatësit ndihmohen nga zyrtarë ligjorë dhe stafi i Sekretariatit të EULEX-it.

Përgjithësisht, Paneli është i vendosur në Prishtinë dhe mban përafërsisht gjashtë seanca në vit. Diskutimet mbahet në seanca të mbyllura dhe vendimet miratohen nga shumica. Gjuhët zyrtare janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze. Edhe pse PShDNj-ja është tërësisht e financuar

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

nga EULEX-i, ai nuk është organ i EULEX-it, kurse PShDNj-ja gjendet në një ndërtesë jashtë zyrave qendrore të EULEX-it në Prishtinë. Nga pikëpamja e rregullores së punës është e paqartë nëse gjykatësit e PShDNj-së përfitojnë nga imuniteti ngjashëm me zyrtarët e EULEX-it, dhe nëse zyrat dhe dokumentet e tyre janë të pacenueshëm.

Sfera e mandatit

PShDNj-ja është në gjendje të shqyrtojë ankesat nga çdo person i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë (për shkak të ndonjë veprimi apo mos veprimi) gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. E rëndësishme është se PShDNj-ja nuk shërben si instancë për shqyrtim (apo organ për ankesa) i ndonjë gjykate të Kosovës.

Në thelb, PShDNj-ja mund të shqyrtoj shkeljet duke u bazuar në instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç janë: Deklarata e përgjithshme e të drejtave të njeriut (1948); Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (KEDNj, 1950); Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KEDR, 1965); Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (KNDP, 1966); Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike shoqërore dhe kulturore (KEDShK, 1966); Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave (KEDG, 1979); Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese (KKT, 1984); Konventa për të drejtat e fëmijëve (KDF, 1989). Tani për tani, vetëm dy prej instrumenteve të mëdha ndërkombëtare që PShDNj-ja nuk ka mandat t'i shqyrtojë janë: Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar (KDPAK, 2006) dhe Protokollin e saj opsional (2006).

Është interesante se lista e mësipërme e atyre instrumenteve nuk gjendet në rregulloren e punës së PShDNj-së, mirëpo vetëm në faqen e tyre të internetit. Ndryshe prej kësaj, Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut i UNMIK-ut ka vendosur në listë konventat që mund t'i shqyrtojnë në nenin 1.2 të rregullores vet të punës. Mandati i gjerë juridik përfshinë traktatet e KB-së dhe një konventë rajonale bën të domosdoshme nevojën që gjykatësit të kenë përvojë të gjerë. PShDNj-ja do të jetë në gjendje të shqyrtoj jo vetëm të drejtat civile dhe politike, mirëpo edhe të drejtat shoqërore, ekonomike, dhe kulturore. PShDNj-ja mund që drejtpërdrejtë ta zbatojë DUDNj. Sipas këtij këndvështrimi, ai është vetëm organi i dytë i një natyre të tillë që mund të bëjë atë; i pari është Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut i UNMIK-ut. Fushëveprimi i gjerë i instrumenteve ndërkombëtare në të cilat mund të mbështetet PShDNj-ja sa i përket një mekanizmi llogaridhënës të këtij lloji është me të vërtetë i jashtëzakonshme dhe që ofron agjendë ambicioze.

Procedura

Ankesa mund të parashtrohet pranë PShDNj-së nga vetë viktimja, apo nga përfaqësuesi i autorizuar që përfaqëson viktimën. Duhet që ankesa të parashtrohet me shkrim, dhe shkeljet e dyshuara duhet që të kenë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008.

Pasi që ankesa të konsiderohet e pranueshme, Paneli kërkon që shefi i Misionit të EULEX-it të ofroj përgjigje. Pastaj, Paneli formulon gjetjet e tij lidhur me shkeljen e dyshuar të të

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

drejtave të njeriut dhe i publikon ato në një vendim të arsyeshëm, e cila përfshinë rekomandime jo detyruese që i ofrohen shefit të Misionit. Varet nga shefi i misionit që në fund të vendos çfarë masa korrigjuese do të ndërmerren, dhe se pritet që ai do ta arsyetoj vendimin e tij duke vepruar ashtu. Për më tepër, PShDNj-ja ka mandat që të bëjë përcjelljen e gjetjeve, sa i përket zbatimit të rekomandimeve të tij nga ana e shefit të Misionit. Paneli menjëherë i publikon të gjitha vendimet e veta, përfshirë çdo vendim pasues.

Lëndët

Deri më tani, Paneli ka shqyrtuar 46 lëndë, 14 prej tyre i ka gjetur të pranueshme. Në dy raste PShDNj-ja ka gjetur se EULEX-i ka shkelur dispozita të caktuara të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut. Në një të tretën prej këtyre lëndëve, PShDNj-ja tashmë ka publikuar gjetjet pasuese. Në lëndët e fundit gjetjet kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për kompensim efektiv, të drejtën për jetë dhe të drejtën për mos t'ju nënshtruar torturës.

Si tendencë e përgjithshme, PShDNj-ja deri më tani ka pranuar ankesa kryesisht lidhur me shkeljet e dyshuara sipas KEDNj-së (më shumë se çfarëdo instrumenti tjetër i të drejtave të njeriut në dispozicion). Një tjetër shpjegim i mundshëm është njohja më e mirë e dispozitave të KEDNj-së nga ankuesit. Mbetet e hapur pyetja nëse PShDNj-ja mund të shqyrtoj proprio motu (sipas nismës së vetë) shkeljet e ngjashme sipas instrumenteve të tjera përkatëse të të drejtave të njeriut atëherë kur kanë të bëjnë saktësisht me të drejtat e mbrojtura apo të personave (p.sh. KDF apo KEDR). Më së shumti është pretenduar se ka pasur shkelje për këto të drejta si në vijim: shkelja e së drejtës për jetë; ndalimi i torturës; e drejta për liri dhe siguri; e drejta për gjykim të drejtë; e drejta për respektim të jetës private dhe familjare; liria e shprehjes; dhe e drejta për kompensim efektiv.

Në gjetjet e tij, PShDNj-ja ka cituar gjerësisht jurisprudencën e KEDNj-së dhe është përpjekur që ta interpretoj mandatin e vetë sipas synimeve të përgjithshme të EULEX-it, ashtu siç saktësohen në Veprimin e përbashkët të Këshillit Evropian 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 që e themelon EULEX-in.

Disa prej gjetjeve të rëndësishme gjenden në jurisprudencën e sapokrijuar të PShDNj-ja. Së pari, në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, PShDNj-ja ka gjetur se një prej elementeve të rëndësishme të së drejtës për qasje në gjykatë që garantohet sipas nenit 6 (1) të KEDNj-së është ekzekutimi i vendimeve përfundimtare dhe detyruese. Pa ekzekutimin e duhur të vendimeve të tilla, PShDNj-ja ka konstatuar se e drejta për gjykim të drejtë mbetet iluzion dhe i paefektshëm. Arsyetimi i PShDNj-së është bazuar në pohimin se sipas jurisprudencës së KEDNj-së, ekzekutimi i aktvendimit që është marrë nga ndonjë gjykatë duhet të shihet si pjesë përbërëse e “gjykimit”, sipas nenit 6 të KEDNj-së.

Së dyti, PShDNj-ja ka ofruar të dhëna të rëndësishme rreth fushëveprimit të saktë të mandatit dhe kompetencave të veta. Për shembull, është konstatuar se përderisa Paneli mund t'i shqyrtoj veprimet e EULEX-it apo të policisë derisa ato lëndë hyjnë në kuadër të “mandatit ekzekutiv” të EULEX-it, Paneli nuk mund të shqyrtoj punën administrative dhe juridike të gjykatave të Kosovës, edhe nëse aty është i përfshirë EULEX-i (për shembull për shkak të pjesëmarrjes së gjykatësit). Gjithashtu PShDNj-ja konsideron se “mandati

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

ekzekutiv” i EULEX-it nuk përfshinë çështjet e karakterit administrativ sa i përket banimit, ofrimit të kujdesit shëndetësor, ndotjes apo çështjes së politikës sociale. Mund të shtrohet pyetja se cilat janë ato shkelje të të drejtave shoqërore ekonomike dhe kulturore që Paneli mund ta konsideroj veten kompetent për t’i shqyrtuar në të ardhmen sipas një interpretimi të tillë të ngushtë të mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Në anën tjetër, PShDNj-ja ka pranuar se pamundësia e supozuar nga ana e parashtruesve të ankesës për të gjetur zgjidhje të duhura gjyqësore sa i përket shkeljeve të tilla ngrit çështje të rëndësishme sa i përket “ligjit dhe faktit”, siç është e drejta për qasje në drejtësi. Prandaj Paneli ka pranuar se ka kompetencë që në këtë drejtim ta shqyrtoj ankesën.

Së treti, PShDNj-ja ka treguar se është i gatshëm të hyjnë dhe të identifikoj të drejtat që vërehen se janë shkelur edhe nëse ato nuk janë përmendur drejtpërsëdrejti nga ana e ankuesit, ku në tërësinë e dëshmisë paraqitet një tregues i qartë i shkeljeve të mundshme. Së fundi kështu është vepruar në lëndën W kundër EULEX-it, ku Paneli ka vendosur se ankesa e ankuesit në thelb ka të bëjë me të drejtën për jetë, të drejtën për mos nënshtrim ndaj torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera çnjerëzore apo poshtëruese, dhe të drejtës për jetë private dhe familjare. Për më tepër, sipas këndvështrimit të të drejtave të mbrojtura të rëndësishme, PShDNj-ja në këtë lëndë ka rekomanduar që EULEX-i të ndërmerr masa të caktuara të përkohshme sipas Rregullës 22 të Rregullores së vet të punës, në mënyrë që të mbrojë sigurinë e ankuesit përderisa Paneli diskuton rreth meritave të lëndës.

Përshkrimi i lartshënuar i jurisprudencës tregon se PShDNj-ja po lëviz shpejt drejt zhvillimit të jurisprudencës së vetë, duke u bazuar gjerësisht në synimin dhe qëllimin e mandatit të EULEX-it, përderisa është i kujdesshëm që mos të merret shumë me kreativitetin gjyqësor.

Zbatimi i rekomandimeve

Masat korrigjuese që PShDNj-ja i ka rekomanduar deri më tani janë konkrete dhe vepruese. Ndër të tjera, PShDNj-ja ka sugjeruar se shefi i Misionit të veproj për të përshpejtuar procedurat që prekin të drejtën e një ankuesi, në mënyrë që mos të shkaktohet shkelje tjetër e së drejtës për t’u dëgjuar në mënyrë të drejtë sipas nenit 6(1) të KEDNj-së, dhe se shefi i Misionit t’i hulumtoj mënyrat për të siguruar zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore.

Masat që shefi i Misionit ka raportuar se i ka ndërmarrë si përgjigje ndaj rekomandimeve të PShDNj-së kanë qenë në mënyrë të ngjashme konkrete, megjithatë në disa raste jo të kënaqshme. Kështu për shembull, shefi i Misionit ka konstatuar se “ai e kupton dhe ndjen keqardhje për gjendjen e ankuesit dhe se ai është në dijeni të plotë rreth grumbullit të madh të lëndëve gjyqësore që nuk janë të përfunduara brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Për fat të keq, në këtë rast Paneli ka konsideruar se kjo ishte përgjigje e arsyeshme, dhe ka vënë re se shefi i Misionit të EULEX-it i kishte ushtruar funksionet e tij siç duhet. PShDNj-ja është bazuar në gjetjet se ai “kishte marrë masa të caktuara për t’ju qasur gjendjes së ankuesit”. Mbetet të interpretohet nëse një prag i tillë i ulët i kujdesit të duhur do të vazhdojë që edhe në të ardhmen t’i kënaq gjykatësit, mirëpo ka gjasa që gjithashtu të shtrohet çështja efektivitetit të këtij mekanizmi për të ofruar një zgjidhje. Suksesi i PShDNj-ja si organ këshillëdhënës do të matet jo vetëm nga saktësia e vendimeve të tij, mirëpo gjithashtu edhe

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

nga zbatimi i rekomandimeve të tij, dhe se çfarë ndryshimi thelbësor i ofron gjendjes së ankuesit.

Strategjia e fushatës informuese



Anëtarët e PShDNj-së në takim me studentët e Universitetit të Prishtinës

PShDNj-ja që prej vitit 2010 zbaton një strategji ambicioze sa përket fushatës informuese. Kjo i përfshinë takimet me organizatat civile, autoritetet përkatëse publike, dhe qytetarët. Për vitin 2011, fushata informuese ishte përqendruar në

administratën komunale. Paneli gjithashtu ka arritur të shikohet përmes TV/radios dhe mediave të tjera. Që prej vitit 2011, PShDNj-ja ka vazhduar fushatën informuese edhe në Serbi. Kjo duket se është një hap premtues, aty ku është e parashikueshme se mbretëron një marrëdhënie mjaft e ndjeshme në një mjedis të tensionuar shumë etnik. Do të jetë interesante që të shihet nëse në të ardhmen PShDNj-ja do të shkëmbejë përvojën dhe mësimet e nxjerra me Panelin Këshillëdhënës të të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut apo Institucionin e Avokatit të Popullit, dhe nëse do të bashkëveprojë me organet për zbatimin e traktateve të OKB-së, të cilat kanë mandat të saktësuar për të interpretuar konventat e përmendura në mandatin e tij.

Përparësitë e mundshme të PShDNJ-së

Siç dihet, EULEX-i gëzon imunitet ndaj proceseve vendore ligjore dhe administrative. Prandaj, vendimi për të krijuar PShDNj-në është një shprehje e të kuptuarit se EULEX-i nuk mund të shihet se iu shmanget llogaridhënies, për shkak të imunitetit të tij. Në atë kuptim, themelimi i këtij Paneli tashmë është një hap drejt marrjes së përgjegjësive rreth të drejtave të njeriut nga organizatat ndërkombëtare. Për më tepër, ky mekanizëm, ashtu siç është tani funksional, përpiqet të forcojë synimet e përgjithshme të misionit të EULEX-it për të promovuar sundimin e ligjit. Sa i përket kësaj, në funksionimin e tanishëm të PShDNj-së disa aspekte janë mjaft premtuese.

Së pari, gati vetëm duke u mbështetur në themelimin e tij, PShDNj-ja është duke ofruar një shkallë të transparencës në punën e EULEX-it, e cila është e pashembullt në misionet e tjera të BE-së apo OKB-së nëpër botë. Prandaj kjo paraqet jo vetëm një forum për zgjidhjen e shkeljeve, mirëpo gjithashtu një mekanizëm për vetë rregullim dhe përmirësim brenda vetë EULEX-it.

Së dyti, Paneli tashmë ka përmbushur premtimin e vet për të ofruar gjetje konkrete dhe të arsyeshme, dhe për të vepruar në mënyrë të shpejtë dhe të paanshme. PShDNj-ja ka marrë vendimin e parë në prill të vitit 2010, kurse përbërja e gjykatësve të Panelit kishte ndryshuar

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

mjaft shumë në mesin e viteve 2010 dhe 2012. Paneli nuk ka ngadalësuar shqyrtimin e ankesave në vitin 2011, edhe pse ato u shtuan si në numër dhe ndërlíkueshmëri.

Së treti, përmes fushatës së tij informuese, PShDNj-ja nuk është duke bërë vetëm thjeshtë informimin e shoqërisë civile dhe zyrtarëve rreth punës dhe procedurave të veta, mirëpo ai gjithashtu është duke kultivuar një sensibilizim të përgjithshme të të drejtave themelore të njeriut dhe mekanizmave për ofrimin e zgjidhjeve, e cila shërben për një edukim të rëndësishëm objektiv sa i përket riafirmimit të vlerës dhe besimit në sundimin e ligjit. Kjo vetëm se do ta shtynte përpara synimin kryesor të EULEX-it në Kosovë.

Disa sfida të ardhshme për PShDNj-në

Në këtë fazë të hershme të ekzistencës së PShDNj-ja, ndoshta është ende herët që të ofrohet ndonjë përfundim rreth efikasitetit të punës së tij. Siç është vërejtura në pjesën më lartë, PShDNj-ja deri më tani është marrë me shumë lëndë, në këtë mënyrë duke treguar se është i paanshëm dhe i shpejtë. Sidoqoftë, ekzistojë disa sfida përpara. E para ka të bëjë me financimin, personelin dhe burimet. Tani, ky mekanizëm i merr fondet e veta tërësisht nga buxheti i EULEX-it. Për më tepër, jurisprudenca dhe praktika e KEDNj-së tregon se pavarësia dhe paanësia e vërtetë (e kuptuar) mund të vijë vetëm përmes një buxheti të pavarur. Çështja nëse EULEX-i do t'i shqyrtoj mënyrat për të arritur një pavarësi të tillë mbetet e hapur, mirëpo kjo në rend të parë është po aq e rëndësishme sa edhe nisma për krijimin e një mekanizëm të tillë.

Së dyti, përderisa është duke u zhvilluar jurisprudenca e PShDNj-së, ndoshta do të ketë më shumë qartësi rreth kuptimit të saktë dhe shtrirjes së termit “mandati ekzekutiv” i EULEX-it, i cili qëndron si thelbi i dispozitave për pranueshmërinë e lëndëve nga PShDNj-ja. Dosja e tanishme nxjerr në pah një qasje të kujdesshme, mirëpo do të jetë e rëndësishme për PShDNj-në që mos të shihet si një mekanizëm i cili vetëm se e ruan apo shfaqëson EULEX-in nga përgjegjësia duke e përdorur një interpretim formal të termit “mandati ekzekutiv”.

Ngjashëm, mbetet të shihet se si PShDNj-ja do të përpiqet t'i shpjegoj viktimës se nuk ka autoritet për të ofruar kompensim financiar për dëmet e shkaktuara apo për të ofruar vendime detyruese. Deri më tani këtë e ka bërë të qartë gjatë fushatës informuese, mirëpo duhet të ketë përpjekje të përbashkëta nga gjykatësit e Panelit për të treguar se gjetjet dhe rekomandimet që ata i marrin shërbejnë vetëm si një mjet i rëndësishëm për të ofruar përmirësime dhe korrigjime si çdo kompensim material. Një tipar i rëndësishëm i PShDNj-së që nuk duhet të mbetet i pavërejtur, për shembull, është se parashtrimi i ankesës pranë PShDNj-së nuk paguhet, e që nuk ndodh me procedurat gjyqësore vendore. Në parim, një mundësi tjetër mbetet ndjekja e kompensimit përmes Policës së Sigurimit të Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë për dëmet e pësuar, bazuar në gjetjet nga PShDNj-ja.

Sa i përket vetë strategjisë së fushatës informuese, sfidat do të vazhdojnë lidhen me informimin e autoriteteve publike dhe të shoqërisë civile rreth detyrave dhe kompetencave të sakta të Panelit dhe shmangies së një rritje të shpejtë të ankesave të papranueshme për shkak të mungesës së njohjes së mandatit të tij.

Përfundim

Varësisht prej marrjes së vendimeve të ardhshme rreth personelit, burimeve dhe financave të PShDNj-së, si dhe varësisht prej nivelit që shihet se sa EULEX-i mundëson zbatimin e vendimeve të lëshuara nga PShDNj-ja dhe sa mundëson zbatimin e masave efektive korigjuese, Paneli mund të shndërrohet në një mekanizëm unik që siguron një rezultat më të mirë nga ana e EULEX-it dhe kontribuon në mësimet e nxjerra për misionet e ardhshme të BE-së.

Edhe pse është shumë herët të matet ndikimi, treguesit do të përfshijnë përshtatshmërinë dhe transparencën e gjetjeve, nivelin e përfshirjes së shoqërisë civile, bashkëpunimin me shefin e Misionit të EULEX-it, dhe zbatimin e rekomandimeve. Mirëpo duke treguar se është i gatshëm t'ju nënshtrohet një shkalle të përgjegjësisë rreth të drejtave të njeriut, EULEX-i tashmë është duke bërë një hap përpara në drejtimin e duhur.

Së fundi, nuk duhet harruar se ekzistojnë shumë mënyra të tjera të ngjashme për të ofruar përgjegjësi. Sidomos, përgjegjësia ligjore duhet të sigurohet në rend të parë nga mekanizmat gjyqësorë të shteteve pjesëmarrëse të BE-së. Kështu, edhe pse PShDNj-ja do të mbetet një forum unik për viktimat, ai nuk do të jetë “shkopi magjik” i cili do t'i zgjidh të gjitha problemet që dalin nga shkeljet e të drejtave të njeriut që lidhen me praninë e EULEX-it në Kosovë.

Mariya Nikolova mban titullin e masterit në të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare nga ADH Akademia e Gjenevës për të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. Ajo më herët ka qenë trajnere ligjore në Tribunalin e Posaçëm për Liban dhe asistente për redaktim të Revistës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, ICRC.

SHTOJCA 6 Tabela e jurisprudencës

E përditësuar më: 23 janar 2013

1. JURIDIKSIONI & PRANUESHMËRIA

1.1. Çështjet e përgjithshme

1.1.1. **Fushëveprimi i autoritetit shqyrtues të Panelit**

X. dhe 115 ankues të tjerë, 2011-20, 5 tetor 2012, në paragrafin 55
Hamiti kundër EULEX-it-it, 2012-01, 5 qershor 2012, në paragrafin 16-17
Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafin 36-37
Sharku kundër EULEX-it, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafin 20-21
Trajkovic kundër EULEX-it, 2011-12, 23 nëntor 2011, në paragrafin 12
Blakqori kundër EULEX-it, 2011-06, 23 nëntor 2011, në paragrafin 18
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 52-64

1.1.2. **Koncepti llogaridhënës**

Pajaziti kundër EULEX-it, 2012-05, 4 tetor 2012, në paragrafin 9
Zeka kundër EULEX-it, 2012-02, 4 tetor 2012, në paragrafin 21
Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafin 36
Sharku kundër EULEX-it, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafin 18
Lazic kundër EULEX-it, 2011-24, 23 nëntor 2011, në paragrafin 18
Gashi kundër EULEX-it, 2011-22, 23 nëntor 2011, në paragrafin 12
Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011, në paragrafin 19
Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 14
Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011, në paragrafin 14
S.M. kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, në paragrafin 13
Blakqori kundër EULEX-it, 2011-06, 23 nëntor 2011, në paragrafin 18
Gecaj kundër EULEX-it, 2011-01, 23 nëntor 2011, në paragrafin 48
Jovanovic kundër EULEX-it, 2011-10, 14 shtator 2011, në paragrafin 31
Rruka kundër EULEX-it, 2011-08, 14 shtator 2011, në paragrafin 10
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 53

1.1.3. **Vendim rreth pranueshmërisë pa paragjykuar meritat**

X. dhe 115 ankues të tjerë, 2011-20, 5 tetor 2012, në paragrafët 56-57
W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012 pas paragrafit 30

1.2. Kufizimet e juridiksionit

1.2.1. **Juridiksioni racione temporis (pas 9 dhjetorit 2008 – datë kur EULEX-i është bërë operacional)**

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 71-77

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

- 1.2.2. **Juridiksioni racione personae – nuk ka kompetenca për shqyrtim ndaj UNMIK-ut**
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011 paragrafët 78-82
- 1.2.3. **Nuk ka juridiksion ndaj procedurave që zhvillohen jashtë Kosovës**
Gecaj kundër EULEX-it, 2011-01, 23 nëntor 2011, në paragrafin 53
- 1.2.4. **Kontrolli ligjor ndaj sjelljes së kontestuar jo domosdoshmërisht është pengesë për juridiksionin e Panelit**
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 61 (me implikim)
- 1.2.5. **Kompetenca ndaj çështjeve “diskrecionale” (të prokurorit)**
Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 234 nëntor 2011, në paragrafin 24

1.3. Personeli i EULEX-it dhe rekrutimi

- 1.3.1. **Nuk ka kompetencë ndaj ankesave prej personelit të EULEX-it**
Një punëtor i EULEX-it kundër EULEX-it, 2010-13, 14 shtator 2010, në paragrafin 5
- 1.3.2. **Ankesat rreth procedurave të rekrutimit të EULEX-it**
Luizim Gashi kundër EULEX-it, 2010-14, 7 dhjetor 2010, në paragrafin 7
Pasuli kundër EULEX-it, 2010-12, 14 dhjetor 2010, në paragrafin 7
Proetel kundër EULEX-it, 2010-10, 14 dhjetor 2010, në paragrafin 6

1.4. Procedurat pranë Gjykatave në Kosovë

- 1.4.1. **Procedurat gjyqësore pranë gjykatave në Kosovë – nuk është përfshirë EULEX-i**
Hamiti kundër EULEX-it, 2012-01, 5 qershor 2012, në paragrafin 17
Mustafa kundër EULEX-it, 2011-03, 8 prill 2011, në paragrafin 22
Sefa kundër EULEX-it, 2010-15, 23 shkurt 2011, në paragrafin 12
Krstic kundër EULEX-it, 2010-08, 23 shkurt 2011, paragrafët 16-17
- 1.4.2. **Procedurat gjyqësore nga gjykata në Kosovë – përfshirja e EULEX-it/kontakti me EULEX-it**
Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 21
Pajaziti kundër EULEX-it, 2012-05, 4 tetor 2012, në paragrafët 9-10
Dobruna kundër EULEX-it, 2012-03, 4 tetor 2012, në paragrafin 12
Zeka kundër EULEX-it, 2012-02, 4 tetor 2012, në paragrafin 21
Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafin 36
Maznikolli kundër EULEX-it, 2011-21, 20 mars 2012, në paragrafin 15
Lazic kundër EULEX-it, 2011-24, 23 nëntor 2011, në paragrafin 20
Gashi v EULEX-it, 2011-22, 23 nëntor 2011, në paragrafët 13-15
Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011, në paragrafin 19
Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 14
Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011, në paragrafin 15
S.M. kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, në paragrafin 14
Blakqori kundër EULEX-it, 2011-06, 23 nëntor 2011, në paragrafin 18
Gecaj Kundër EULEX-it, 2011-01, 23 nëntor 2011, në paragrafin 50
Shabani kundër EULEX-it, 2011-14, 14 shtator 2011, në paragrafin 18
Jovanovic kundër EULEX-it, 2011-10, 14 shtator 2011, në paragrafët 32-34
Rruka kundër EULEX-it, 2011-08, 14 shtator 2011, në paragrafët 11-13

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

SYRI kundër EULEX-it, 2011-05, 14 shtator 2011, në paragrafin 11
Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it, 2011-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 46-47
Agovic kundër EULEX-it, 2010-16, 8 dhjetor 2010, në paragrafin 21
Ramadani kundër EULEX-it, 2010-09, 8 qershor 2011, paragrafin 28

1.4.3. **Personeli / pjesëmarrja në një organ nuk e ndryshon karakterin e gjyqësorit të Kosovës**

Pajaziti kundër EULEX-it, 2012-05, 4 tetor 2012, në paragrafin 9-10
Dobruna kundër EULEX-it, 2012-03, 4 tetor 2012, në paragrafin 12
Zeka kundër EULEX-it, 2012-02, 4 tetor 2012, në paragrafin 21
Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafin 36
Maznikolli kundër EULEX-it, 2011-21, 20 mars 2012, në paragrafin 15
Lazic kundër EULEX-it, 2011-24, 23 nëntor 2011, në paragrafin 20
Gashi kundër EULEX-it, 2011-22, 23 nëntor 2011, në paragrafin 13
Gecaj Kundër EULEX-it, 2011-01, 23 nëntor 2011, në paragrafin 50
Jovanovic kundër EULEX-it, 2011-10, 14 shtator 2011, në paragrafin 33
Rruka kundër EULEX-it, 2011-08, 14 shtator 2011, në paragrafin 12
“SYRI” kundër EULEX-it, 2011-05, 14 shtator 2011, në paragrafin 11

1.5. **Veprimet e EULEX-it**

1.5.1. **Autoriteti shqyrtues dhe lidhja e mjaftueshme materiale midis akteve dhe veprimeve të EULEX-it**

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 84-85

1.5.2. **Kompetenca e Panelit për të shqyrtuar veprimet /mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it**

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, në paragrafët 34-35
W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012, në paragrafin 21
Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011, në paragrafin 22
Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011, në paragrafin 16
S.M. kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, në paragrafin 15
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 52-64

1.5.3. **Llogaridhënia – Përgjegjësia për mosveprim**

Sharku kundër EULEX-it, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafët 19-20
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011 paragrafët 91-94
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, paragrafët 74-75

1.6. **Mandati i EULEX-it**

1.6.1. **Kufizimi i mandatit të EULEX-it dhe kompetencat për të shqyrtuar**

Sharku kundër EULEX-it, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafin 21

1.6.2. **Aspektet “Ekzekutive” të mandatit të EULEX-it si dhe kufijtë e kompetencave**

Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 23 (kujdestaria ndaj fëmijëve)
X. dhe 115 ankues të tjerë, 2011-20, 5 tetor 2012, në paragrafët 43-53 (kujdesi mjekësor, ndotja, çështjet e banimit, mbrojtja e mjedisit)
Maznikolli kundër EULEX-it, 2011-21, 20 mars 2012, në paragrafin 15

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Asllani kundër EULEX-it, 2011-26, 23 nëntor 2011 (zbatimi i vendimeve të gjykatave të Kosovës nuk janë përfshirë), në paragrafin 33

Trajkovic kundër EULEX-it, 2011-12, 23 nëntor 2011, në paragrafin 12 (bastisja e shtëpisë si mandat ekzekutiv)

Shabani kundër EULEX-it, 2011-14, 14 shtator 2011, në paragrafët 16-18 (e drejta familjare)

Azemi kundër EULEX-it, 2011-17, 8 qershor 2011, në paragrafin 3 (punësimi nuk është përfshirë)

Mirkovic kundër EULEX-it, 2011-09, 8 qershor 2011, në paragrafët 14-15 (punësimi dhe disiplina e brendshme nuk është përfshirë)

Gecaj Kundër EULEX-it, 2011-01, 23 nëntor 2011, në paragrafin 48

1.6.3. Mandati “ekzekutiv” dhe gjykatësit e EULEX-it

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, në paragrafin 34

1.7. Çështjet e tjera

1.7.1. Njohja e të drejtave të ankuesve nga EULEX-i

Maxhera kundër EULEX-it, 2012-04, 4 tetor 2012, në paragrafët 12-13

1.7.2. Nuk ka kompetencë ndaj çështjeve tatimore

Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011, në paragrafin 20

1.7.3. Nuk ka kompetencë për shqyrtim ndaj kontesteve private

Gashi kundër EULEX-it, 2011-25, 20 mars 2012, në paragrafët 8-9

Rudi kundër EULEX-it, 2010-11, 14 shtator 2010, në paragrafin 6

1.7.4. PShDNj-ja nuk është gjykatë e apelit

Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 21

Sharku kundër EULEX-it, 2011-19, 20 mars 2012, në paragrafët 21

1.7.5. Kompetencë jo e drejtpërdrejtë e Panelit për shqyrtim

Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafët 37-38

1.7.6. Afati 6 mujor për parashtrimin e ankesave

Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 25

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, në paragrafin 25-33

Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafët 39-42

Gashi kundër EULEX-it, 2011-22, 23 nëntor 2011, paragrafët 16-17

Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011, në paragrafët 17-18

Trajkovic kundër EULEX-it, 2011-12, 23 nëntor 2011, në paragrafët 13-14

S.M. kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, në paragrafët 16-18

Blakqori kundër EULEX-it, 2011-06, 23 nëntor 2011, në paragrafët 19-20

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 51

1.7.7. Statusi ‘viktimë’

Ibishi kundër EULEX-it, 2012-07, 15 janar 2013, në paragrafët 6-8

Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafët 43-47

Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 15

1.7.8. Actio popularis (për interes publik si tërësi)

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Ibishi kundër EULEX-it, 2012-07, 15 janar 2013, në paragrafin 7

- 1.7.9. **Detyrimet e vazhdueshme të EULEX-it** (ndaj veprimeve të UNMIK-ut)
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 83-97 veçanërisht në paragrafin 88
- 1.7.10. **Kompetenca ekzekutive – policia – kompetenca korrigjuese të EULEX-it**
Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it, 2011-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 39

2. ÇËSHTJE PROCEDURALE

2.1. Përbërja e Panelit

- 2.1.1. **Mundësia për të marrë pjesë në mungesë të një anëtari**
Hamiti kundër EULEX-it, 2012-01, 5 qershor 2012, në paragrafin 2
- 2.1.2. **Largimi apo përjashtimi i një anëtari të Panelit /Sekretariatit**
X. dhe 115 ankues të tjerë, 2011-20, 5 tetor 2012, në paragrafin 3
Zeka kundër EULEX-it, 2012-02, 4 tetor 2012, në paragrafin 1
Lazic kundër EULEX-it, 2011-24, 23 nëntor 2011, në paragrafin 2
Jovanovic kundër EULEX-it, 2011-10, 14 shtator 2011, në paragrafin 2
Rruka kundër EULEX-it, 2011-08, 14 shtator 2011, në paragrafin 2
“SYRI” kundër EULEX-it, 2011-05, 14 shtator 2011, në paragrafin 2
- 2.1.3. **Mundësia që vendimi të merret ‘nga shumica’**
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 23 nëntor 2011, pas paragrafit 77
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, pas paragrafit 88

2.2. Informata, pyetje, parashtrime

- 2.2.1. **Mjetet procedurale për të kërkuar informata**
Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 9
- 2.2.2. **Kompetenca e Panelit për të informuar ankuesin rreth mundësisë për ri-parashtrim të ankesës**
Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 17
- 2.2.3. **Kërkesë për parashtrimet e palëve**
Berisha kundër EULEX-it, 2011-04, 14 shtator 2011, në paragrafin 2 dhe 3
Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it, 2011-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 2 dhe 4
- 2.2.4. **Mundësia e kërkimit të hapave procedural të marra nga autoritetet përkatëse**
Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it, 2011-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 3
- 2.2.5. **Kërkesë për informim dhe gjendja e zbatimit të pjesërisht të kërkesës**
Mehmetaj kundër EULEX-it, 2010-03, 14 shtator 2011, në paragrafin 2
- 2.2.6. **Kërkesë nga Paneli për të shqyrtuar dosjen e lëndës**
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 4

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

2.2.7. **Mundësia e kontaktimit të drejtpërdrejtë (përmes postës elektronike) me aplikantin**
Luizim Gashi kundër EULEX-it, 2010-14, 7 dhjetor 2010, në paragrafin 1

2.2.8. **Njoftimi i shefit të Misionit dhe kërkesa për pikëpamje**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafin 1

2.3. Çështjet e ankuesit

2.3.1. **Çështjet e përfaqësimit të ankuesit**
Smajli kundër EULEX-it, 2011-15, 23 nëntor 2011, në paragrafin 17

2.3.2. **E drejta e ankuesit për t'u dëgjuar**
Berisha kundër EULEX-it, 2011-04, 14 shtator 2011, në paragrafët 2-3 dhe 18
Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it, 2011-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 2-4
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafët 4-5
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, në paragrafët 1, 3-4,

2.3.3. **Mos komunikimi i ankuesit me Panelin dhe për pasojë vjen deri te heqja e ankesës nga lista**
Berisha kundër EULEX-it, 2011-04, 14 shtator 2011, në paragrafin 19

2.3.4. **Mundësia e riparashtrimit të një ankese**
Berisha kundër EULEX-it, 2011-04, 14 shtator 2011, në paragrafin 20

2.4. Çështje për hetim

2.4.1. **Propozimi i masave të përkohshme për ShM-në (lidhur me hetimin)**
W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012, pas paragrafit 30

2.4.2. **Obligimi për të hetuar**
Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 28
Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 74-77

2.5. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve

2.5.1. **Kompetenca për të përcjellë zbatimin e rekomandimeve**
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, vendim për zbatimin e rekomandimeve të Panelit, 23 nëntor 2011 paragrafin 1 dhe paragrafët 10-13
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, vendim për zbatimin e rekomandimeve të Panelit, 23 nëntor 2011 paragrafin 1 dhe paragrafët 9-10

2.5.2. **Vlerësimi nga ana e Panelit i përpjekjeve të bëra për zbatimin e vendimeve**
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 23 nëntor 2011, në paragrafët 7-10
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 23 nëntor 2011, në paragrafët 10-13

2.6. Rishyrtimi i një ankese

2.6.1. Rregulla 42 dhe fakte të reja

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 janar 2013, në paragrafët 7-10

2.6.2. Rregulla 42 dhe dëshmi të reja

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 janar 2013, në paragrafët 11-15

2.7. Çështje procedurale

2.7.1. Vendim i Panelit *proprio motu* për të mbrojtur identitetin e ankuesit

W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012, në paragrafin 5

3. ÇËSHTJET E PROVAVE

3.1. Vlera e dëshmisë e para datës 9 dhjetor 2008 faktet

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 96-97

4. MERITAT

4.1. Neni 2 KEDNj-ja

4.1.1. Nuk ka shkelje të nenit 2

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, në paragrafët 36-42

4.1.2. Rëndësia e nenit 2 të KEDNj-së

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 65-70

4.1.3. Obligimet pozitive sipas nenit 2 të KEDNj-së, përfshirë detyrën për të bërë hetime

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafët 68-70

4.1.4. Neni 2 dhe nevoja për një sistemi efektiv gjyqësor

Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, në paragrafin 69

4.2. Neni 3 KEDNj-ja

4.2.1. Niveli minimal i ashpërsisë

Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 27

4.3. Neni 5 i KEDNj-së

4.3.1. Nuk ka shkelje të nenit 5

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, në paragrafët 43-44

4.3.2. Kohëzgjatja e paraburgimit

Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011, në paragrafët 15-16

4.4. Neni 6 KEDNj-ja

4.4.1. Të drejtat për gjykim të drejtë

Halili kundër EULEX-it, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 20-22

Dobruna kundër EULEX-it, 2012-03, 4 tetor 2012, në paragrafët 11-12

Rexhepi kundër EULEX-it, 2011-23, 20 mars 2012, në paragrafët 37-38

4.4.2. Kohëzgjatja e procedurave dhe vonesat e panevojshme (si çështje e të drejtave të njeriut)

S.M. kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, në paragrafin 14

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, në paragrafin 77

Krstic kundër EULEX-it, 2010-08, 23 shkurt 2011, në paragrafin 15

4.4.3. Zbatimi i një vendimi si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë

Asllani kundër EULEX-it, 2011-26, 23 nëntor 2011, në paragrafin 35

4.4.4. Të drejtat dhe detyra praktike dhe efektive e autoriteteve për të vepruar në kohën e duhur

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, paragrafin 68

4.4.5. Pasiguria dhe gëzimi efektiv i së drejtës

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, paragrafin 69 dhe paragrafët 71-72

4.4.6. Kompetencat dhe ligjshmëria e organeve administrative për të gjykuar rreth çështjeve të të drejtave (nëse është bërë shqyrtim i plotë gjyqësor)

Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, paragrafët 87-88

4.4.7. Shqyrtim gjyqësor i vendimeve administrative dhe kërkesat për paanësi

Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, paragrafin 88

4.4.8. Nuk ka të drejtë për ndjekje penale

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, paragrafin 42-43

4.4.9. Zbatimi i një vendimi dhe qasja në drejtësi

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011;

4.4.10. Qasja në drejtësi

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, paragrafët 61-62 dhe paragrafin 76

4.5. Neni 8

4.5.1. Nuk ka shkelje të nenit 8

Y. kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, në paragrafët 36-42

4.6. Neni 1 protokolli 1 KEDNj-së

4.6.1. E drejta për pronësi dhe posedim, përfshirë ligjshmërinë e kufizimeve në to

Dobruna kundër EULEX-it, 2012-03, 4 tetor 2012, në paragrafët 11-12

Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafët 70-84

Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, në paragrafët 63-72

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

- 4.6.2. **Kontest i pazgjidhur dhe pritje e ligjshme për pronësi**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafët 61-82
- 4.6.3. **Refuzimi për të zbatuar urdhrin e gjykatës dhe ndërhyja në të drejtën e pronësisë**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafin 76 dhe 80

4.7. Çështje të përgjithshme

- 4.7.1. **Kërkesë autoriteteve për qeverisje të mirë**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafin 74
- 4.7.2. **Kufizimi i të drejtave dhe vendimet e arsyeshme**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, në paragrafin 78

5. KOMPENSIMI

- 5.1. **Mundësia për Panelin që të identifikoj një veprim “të pëlqyer”**
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, paragrafin 86
- 5.2. **Rekomandime për masa korrigjuese**
Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01, 8 prill 2011, pas paragrafit 77
Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 8 qershor 2011, pas paragrafit 89